



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar


Nr. 3082 Prot.

Tiranë, më 10.6.2013

3

MIRATOHET

MINISTRI



MYQEREM TAJ



KURRIKULA KOMBËTARE E ARSIMIT BAZË

PROGRAMI LËNDOR

LËNDA: HISTORI

Klasa: 7-9

Tiranë, 2013

Grupi i punës:

Neritan CEKA

Luan MALLTEZI

Mamica THANATI

Merita SHEME

Ines TODHE

Menduh DËRGUTI

1. TË PËRGJITHSHME

Historia, si një shkencë humane, është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsinë dhe me mprehtësinë e fituar nga përvojat e së shkuarës. Studimi i historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të kuptojnë kompleksitetin e çështjes historike, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë përpikërinë e burimeve historike, duke shmangur analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj.

Ndryshimi është aspekti thelbësor i kushteve të njerëzimit dhe për këtë arsye është dhe një ndër çështjet bazale të studimit të historisë. Ndërsa lëndë të tjera studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, si: institucionet, traditat kulturore, ekonominë, ligjet etj. Historia kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës se si të gjitha këto aspekte kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Ritmet e ndryshimeve historike të aspekteve të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore janë të ndryshme. Historia ofron një shpjegim të mundshëm për dinamikën e ndryshimit të çdo aspekti. Në këtë mënyrë, nxënësi do të mësojë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.

Detyra e programit të Historisë është të drejtojë nxënësit për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të Historisë, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.

Një kuptim i thellë dhe i gjerë i historisë, pasuron përvojën personale të nxënësve, pasi i mëson ata të luajnë rolin e tyre në jetë dhe në shoqëri, si ruajtës të parimeve të një shoqërie demokratike, si trashëgimtarë të shumë kulturave dhe si anëtarë të një bote ekonomikisht të ndërvarur dhe me kultura të ndryshme që jetojnë në harmoni, duke respektuar identitetin e njëra-tjetrës.

Programi i Historisë në klasat 7-9 të arsimit bazë ka në fokusin e tij të studimit historinë e shqiptarëve dhe historinë moderne e bashkëkohore të qytetërimeve botërore.

Studimi i përvojës së shqiptarëve në të kaluarën, veçoria dhe larmia e saj, është e domosdoshme që nxënësi të kuptojë kushtet shoqërore dhe shtysat e saj. Duke njohur përmes fakteve, përvojën e kaluar të vendit ku jeton, nxënësi thellohet në zbulimin dhe në kuptimin e rrënjëve të identitetit të tij dhe të traditave të trashëguara.

Përvoja njerëzore, e trajtuar në një kornizë kronologjike e tematike, nuk paraqitet e kufizuar vetëm në një aspekt të jetës, por trajton të gjitha problemet që lidhen me qytetërimin, duke filluar nga elementet e jetës së përditshme e deri te sistemet ekonomike, politike e kulturore.

Programi trajton ngjarjet historike në vazhdimësi kronologjike, e cila mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimin botëror. Ai synon që të krijojë te nxënësi bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak-pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike.

Trajtesa tematike shpreh natyrën përzgjedhëse të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë të gjitha ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Trajtesa tematike ka pasur parasysh edhe vendosjen e një baraspeshe historike mes kontributeve të krijuara në periudha të ndryshme në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve pasardhëse, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Programi i lëndës së Historisë për klasat 7-9 të arsimit të mesëm të ulët, është një dokument zyrtar, pjesë e paketës së dokumenteve zyrtare për Kurrikulën Kombëtare të Arsimit Bazë. Ky program është mbështetur në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar dhe në Standardet e të Nxënësve të Fushës së Shkencave Shoqërore.

Programi i ri i Historisë, i cili shtrihet në klasat 7-9, përmban disa risi themelore, të cilat mendohet të luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e nxënësve me njohuri, aftësi dhe

qëndrime që i përgatisin ata për të përmbushur studimet e mëtejshme, si dhe për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Ky program përmban një ngarkesë konceptuale më të lehtësuar, krahasuar me programet e mëparshme. Nxënësit marrin njohuritë më të domosdoshme për historinë e qytetërimeve evropiane dhe atyre botërore, duke studiuar modelet tipike të këtyre qytetërimeve. Nëpërmjet këtij programi, nxënësit marrin njohuri për historinë e shqiptarëve, brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Rubrika e veprimtarive, e vendosur në program, zhvillon aftësitë kërkuese dhe përpunuese të nxënësve, duke i zgjeruar dhe thelluar më tej njohuritë e tyre, si dhe duke vendosur lidhjen ndërmjet historisë së shqiptarëve dhe historisë së qytetërimeve evropiane dhe botërore.

Një tjetër risi që përcjell programi i Historisë për klasat 7-9, është ndryshimi i raportit ndërmjet njohurive të reja dhe përpunimit të tyre. Ky program i krijon më shumë hapësirë përvetësimit të koncepteve të reja, si dhe zhvillimit të aftësive përmes rritjes së numrit të orëve për përpunimin e njohurive, i cili mund të realizohet dhe nëpërmjet rubrikës së veprimtarive dhe projekteve kurrikulare e ndërkurrikulare (rreth 30 - 40% të totalit të orëve mësimore për secilën klasë).

Programi i Historisë është ndërtuar duke marrë në konsideratë veçoritë konjitive, psikologjike e sociale të nxënësve. Ai është hartuar sipas strukturave bashkëkohore të planifikimit dhe programimit kurrikular. Elementet përbërëse të strukturës dhe përmbajtjes së programit do të ndikojnë në rritjen e shkallës së fleksibilitetit të tyre, duke i ndihmuar dhe lënë dorë më të lirë përdoruesve të tyre (mësuesit, autorët e teksteve, prindërit, specialistët etj.), për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese.

1.2 Përdoruesit e programit

Programi i lëndës së Historisë për arsimin bazë u drejtohet në radhë të parë mësuesve të kësaj lënde, të cilët do ta zbatojnë atë në mësimdhënie dhe në të nxënë. Gjithashtu, programi u drejtohet autorëve të teksteve, të cilët përmes përmbushjes së objektivave mësimorë të programit në tekstet e tyre, bëhen një faktor i rëndësishëm progresi në mësimdhënien e lëndës së Historisë.

Ky program është, gjithashtu, në dispozicion të drejtuesve të shkollave, si dhe të gjithë aktorëve të interesuar për mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe të nxënimit në arsimin bazë.

1.3 Organizimi dhe struktura e programit

Programi i lëndës së Historisë për klasat 7-9 të arsimit bazë është ndërtuar mbi bazën e këtyre linjave:

- Qytetërimet në fillimet e historisë moderne (1450 – 1650)
- Koha e ndryshimeve thelbësore (1650 – 1914)
- Periudha e tronditjeve të mëdha (1914 – 1945)
- Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot)
- Njohuritë historike dhe rrënjët e tij
- Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare deri në shek. V ps.Kr.
- Territoret arbërore në mesjetë (shek. VI – XIV)
- Shqiptarët në periudhën moderne (shek. XV – XIX)
- Rilindja kombëtare shqiptare (vitet „30 të shek. XIX – fillimi i shek. XX)
- Shteti shqiptar gjatë shekullit XX
- Shqiptarët jashtë kufijve politikë (1912 – sot)

Për secilën linjë, në programet përkatëse sipas klasave, përcaktohen numri i orëve dhe përmbajtja e shprehur përmes objektivave të të nxënimit. Termat dhe konceptet orientojnë përdoruesit e programit në organizimin e përmbajtjes.

Përmbajtja e kurrikulës së Historisë për klasat 7-9 është organizuar si më poshtë:

Në **klasën e 7-të**, përmbajtja e lëndës “Historia e qytetërimeve moderne” trajton evoluimin e qytetërimit evropian nga periudha e mesjetës në atë moderne, duke evidentuar frymën e re që ai merr me zbulimet e mëdha gjeografike dhe me lëvizjet e mëdha kulturore, fetare e politike, që përfshinë Evropën pas shekullit XV deri në fillim të shekullit XX. Programi prezanton kthesën e madhe që mori qytetërimi botëror pas Rilindjes Evropiane. Përmes tij, nxënësit kuptojnë ndryshimet rrënjësore në jetën ekonomike, politike, shoqërore, humane,

kulturore, shkencore dhe fetare, të cilat çuan në lindjen e botës moderne dhe patën ndikim në arritjet e qytetërimit bashkëkohor. Programi i klasës së 7-të pasqyron ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike në qytetërimin perëndimor dhe atë botëror. Ai përfshin lindjen e nacionalizmit, i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale në Evropën Qendrore dhe në Ballkan. Gjithashtu, ai trajton edhe fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike, që i siguroi qytetarit të drejtat sociale dhe politike.

Në *klasën e 8-të*, lënda “Historia e qytetërimeve bashkëkohore” trajton tronditjet dhe krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore. Nëpërmjet këtij programi, nxënësit kuptojnë dhe gjykojnë për shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror. Nxënësit mësojnë mbi përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave, veçanërisht atyre ekonomike, si dhe krijojnë bindjen se çdo konflikt rajonal, ose me shtrirje më të gjerë, sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë. Programi i klasës së 8-të krijon një tablo të qartë për drejtimet e ndryshme në fushën e artit, kulturës dhe mënyrave të jetesës në shoqërinë e dy sistemeve (demokratike dhe totalitare).

Programi ka për qëllim t’i njohë nxënësit me shkaqet e fillimit të Luftës së Ftohtë, arsyen e ndarjes së botës në dy blloqe dhe pasojat e saj në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore. Ai do të përshkruajë ecurinë e zhvillimeve të mëvonshme ekonomike, të njohura si “mrekullia ekonomike” ose “vitet e arta”, gjatë së cilës u realizua kalimi në shoqërinë post-industriale dhe triumfoi shteti i mirëqenies sociale. Nxënësit do të prezantohen dhe me prirjet e qytetërimeve të sotme, si ndryshime në strukturën sociale dhe zhvillimin e klasës së mesme, rritjen e rolit të gruas në qeverisje; globalizmin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës, artit dhe arsimit, për të evidentuar prirjen dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme.

Në *klasën e 9-të*, trajtohet historia e shqiptarëve nga periudha parahistorike deri në ditët tona:

Programi i klasës së 9-të ka për qëllim ta njohë nxënësin me rrënjët historike të vendit, të cilit i përket. Nëpërmjet tij, nxënësi do të kuptojë ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare; do të analizojë ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar; do të vlerësojë ndikimin e

ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej.

Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, duke i kuptuar ato në mënyrë kritike, për të bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.

2. SYNIMET E PROGRAMEVE TË HISTORISË PËR KLASAT 7-9

Programet e Historisë për klasat 7-9 synojnë:

- të aftësojnë nxënësit për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- të aftësojnë nxënësit për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- të edukojnë nxënësit me ndenjen e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- të zhvillojnë aftësitë intelektuale të nxënësit për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështjet e ndjeshme historike;
- të përshkruajnë momentet më kulmore të zhvillimit të shoqërisë, nëpërmjet një trajtimi kronologjik tematik;
- të vlerësojnë pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror.
- të zhvillojnë aftësitë e të kuptuarit të historisë së vendit, të Evropës dhe të botës.
- të bëhen të vetëdijshëm për interpretimet e ndryshme të çështjeve të veçanta historike.
- Të zhvillojnë aftësitë bazë të kërkimit historik;
- të vlerësojnë natyrën dhe larminë e provave historike;

- të interpretojnë shoqërinë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen dhe ndikimin e tyre në zhvillimet historike të së ardhmes;
- të interpretojnë efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- të argumentojnë vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- të forcojnë ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë;
- të krijojnë mundësi për punë kërkimore, duke u bazuar në burime historike, për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- të zhvillojnë, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

3. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programet e Historisë për klasat 7-9 të arsimit bazë zbatohen në 210 orë mësimore, nga 70 orë për çdo klasë. Për të siguruar zbatimin sa më të mirë të programit, është e rëndësishme të njihen paraprakisht Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Standardet e të Nxënësit të Fushës së Shkencave shoqërore, ku kjo lëndë bën pjesë, programet e shkencave shoqërore për klasat 1-6, ku lënda e historisë trajtohet e integruar së bashku me lëndët e tjera të fushës së shkencave shoqërore, programet e klasave paraardhëse dhe pasardhëse të Historisë, si dhe programet lëndore të së njëjtës klasë.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

3.1 Objektivat e programit

Objektivat e programit janë dhënë për çdo nënlinjë të linjës. Ata përshkruajnë çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit në përfundim të programit. Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të nxënë çka përshkruhet në objektiva.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore, duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Për shembull, le të marrim objektivin: ***Nxënësit duhet të jetë të aftë “të përdorin një gjerësi burimesh historike dhe informacioni të duhur, duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historitë gojore, medien, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin, si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe për argumentimin e një ngjarjeje historike”.***

Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të përdorin burimet historike dhe ato të informacionit, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i përvetësimit të këtij koncepti historik. Një nivel arritjeje është grumbullimi, përzgjedhja dhe kuptimi i materialit historik. Një nivel më i lartë se ky, është interpretimi i këtij materiali historik në kontekstin e njohurive të marra. Një nivel edhe më i lartë do të ishte gjykimi për të, duke mbajtur qëndrim vetjak, bazuar në argumente.

Objektivat e të nxënësve mund të grupohen në objektiva të:

- **njohurive**, ku nxënësit zhvillojnë njohuritë dhe konceptet e Historisë dhe i zbatojnë ato për të interpretuar, për të integruar dhe për të zgjeruar më tej njohuritë e marra;
- **aftësi**, ku nxënësit zhvillojnë aftësitë e nevojshme për kërkimin historik, për përdorimin e burimeve, për komunikimin për të kaluarën, për problem-zgjidhjen, për komunikimin e ideve dhe të rezultateve, për punën në grup dhe për vendimmarrje të argumentuara;
- **qëndrimeve**, ku nxënësit mbajnë qëndrime që mbështesin me përgjegjshmëri pranimin dhe zbatimin e njohurive shoqërore për të mirën e përbashkët të tyre dhe të shoqërisë.

Objektivat janë formuluar në mënyrë të tillë që të bëjnë qartësisht të dukshme jo vetëm njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat, por edhe metodat dhe veprimtaritë që mund të përdoren për arritjen e tyre.

Vëmendje e veçantë në programin e historisë u duhet kushtuar objektivave që jepen në rubrikën e veprimtarive. Ata nxisin aftësitë intelektuale të nxënësve në marrjen dhe në përpunimin e informacionit historik.

Rëndësi u duhet dhënë edhe zbatimit të objektivave, që u përkasin linjave të përbashkëta të fushës së shkencave shoqërore. Objektivat që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit me anë të teknologjive të komunikimit dhe të informimit, nuk kanë për qëllim vetëm mbledhjen dhe renditjen e informacionit të kërkuar, por ndërveprimin aktiv të nxënësit me këto teknologji në procesin e të nxënësve.

Programi nëpërmjet të gjithë objektivave të tij trajton një numër **konceptesh** dhe **procesesh**, të cilat mbështesin studimin e historisë. Nxënësit duhet t'i kuptojnë këto koncepte, në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në lëndën e Historisë.

KONCEPTE KYÇE JANË:

Kuptimi kronologjik

Kuptimi kronologjik është thelbësor në ndërtimin dhe në shpjegimin e ngjarjeve historike, çka përfshin përdorimin e saktë të datave për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve në një shqyrtim, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik, si dhe duke ditur emrat dhe karakteristikat kryesore të periudhave të studiuara. Nxënësit duhet të identifikojnë ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.

Nxënësit duhet:

- të përdorin saktë datat dhe fjalorin për periudha të ndryshme historike, duke përfshirë periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore;
- të kuptojnë organizimin kronologjik të historisë dhe të vendosin njerëzit dhe ngjarjet në periudhën e saktë historike duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike;
- të ndërtojnë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike;

- të krijojnë një tabelë kronologjike të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri.

Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare

Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare ka të bëjë me të kuptuarin e përvojave, ideve, besimit dhe vlerave të ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të kaluarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën.

Nxënësit duhet të njihen me shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme. Shumëllojshmëria ekziston brenda dhe ndërmjet grupeve për shkak të dallimeve kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare. Njohja e kulturave duhet të arrihet nëpërmjet studimit të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: njohjes të pakicave kombëtare, të shoqërive evropiane dhe atyre joevropiane.

Nxënësit duhet:

- të kuptojnë se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike.

Ndryshimi dhe vazhdimësia

Identifikimi dhe shpjegimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë brenda dhe përgjatë periudhave historike. Kuptimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë është i lidhur ngushtë me kuptimin e temave dhe çështjeve gjithëpërfshirëse të periudhave historike.

Nxënësit duhet:

- të shpjegojnë ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike;
- të analizojnë shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po për këtë;
- të analizojnë arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, e situatave dhe e ndryshimeve historike;

- të kuptojnë dhe të ndërgjegjësohen për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave, të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, evropiane dhe botërore.

Shkaku dhe pasoja

Shkaku dhe pasoja përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.

Nxënësit duhet:

- të analizojnë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë;
- të shpjegojnë pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike.

Rëndësia

Rëndësia ka të bëjë me konsiderimin dhe me vlerësimin e një ngjarjeje historike. Ajo vlerëson pse gjykimet në lidhje me rëndësinë e ngjarjeve historike, çështjeve dhe njerëzve kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Gjithashtu, ajo merr parasysh identifikimin e kriterëve të përdorura për vlerësimin e rëndësisë së një çështje, ngjarje apo personazhi historik, si dhe vlerëson se si këto kriterë dhe vlera janë përdorur në përshkrimet e së shkuarës dhe shpjegimin e së tashmes. Deklaratat rreth rëndësisë janë interpretime që mund të bazohen në vendime të kontestueshme rreth ngjarjeve, çështjeve dhe figurave historike, ato shpesh janë të lidhura me sistemet e vlerave të periudhës në të cilën është shkruar interpretimi.

Nxënësit duhet:

- të vlerësojnë rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme.

Interpretimi

Interpretimi ka të bëjë me të kuptuarit se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime. Njerëzit përfaqësojnë dhe interpretojnë të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj. Interpretimet reflektojnë rrethanat në të cilat ato

bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe filmkrijues).

Nxënësit duhet:

- të kuptojnë pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediesh;
- të shpjegojnë se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;
- të shqyrtojnë një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.

AFTËSI DHE PROCESE KYÇE

Kërkimi historik, përdorimi i burimeve, komunikimi për të kaluarën janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e Historisë nëpërmjet objektivave të saj. Nxënësit duhet t'i përvetësojnë këto aftësi për të arritur progres.

Kërkimi historik

Kërkimi historik përfshin strukturimin e kërkesave në lloje të ndryshme pyetjesh dhe çështjesh historike. Nxënësit duhet të fillojnë të hartojnë dhe të përmirësojnë pyetjet e tyre për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave dhe zgjedhjeve të tyre dhe për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tyre.

Nxënësit mund të përdorin njohuritë e tyre të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojnë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tyre, të cilat ata pastaj i testojnë kundrejt dëshmive.

Nxënësit duhet:

- të identifikojnë dhe të shqyrtojnë, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike ose çështje, duke bërë testimin e hipotezave;
- të reflektojnë në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike.

Përdorimi i burimeve

Njohja e së kaluarës bazohet në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura. Kjo përfshin vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmimeve duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.

Nxënësit duhet:

- të shpjegojnë tipat e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit;
- të kërkojnë, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike;
- të identifikojnë, të zgjedhin dhe të përdorin një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik;
- të vlerësojnë burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike;
- të vlerësojnë historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “historinë e shkruar”.

Komunikimi për të kaluarën

Nxënësit zhvillojnë dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkruarën. Nxënësit duhet të përdorin edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tyre.

Nxënësit duhet:

- të paraqesin shpjegime rreth së kaluarës që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;
- të komunikojnë njohuritë e tyre historike në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.

3.2 Orët mësimore

Programi i Historisë për **klasën e 7-të, klasën e 8-të dhe klasën e 9-të** zhvillohet në **70 orë mësimore vjetore/secila klasë** (210 orë mësimorë në tri vite) prej të cilave 60-70% njohuri të reja kundrejt 40-30% përpunim i njohurive.

Programi i lëndës së Historisë për klasën e 7-të, të 8-të dhe të 9-të, është strukturuar në linja dhe nënlinja (blloqe tematike), që vijnë njëra pas tjetrës. Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Zbatuesit e programit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Ata duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës.

Të ndara sipas klasave, linjat dhe orët e sugjeruara jepen të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Klasa	Linja	Orë të sugjeruara
7	Qytetërimet në fillimet e historisë moderne	22
	Koha e ndryshimeve thelbësore	48
8	Periodha e tronditjeve të mëdha (1914 – 1945)	32
	Qytetërimet e sotme bashkëkohore (1945 – sot)	38
9	Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare	7
	Territoret arbërore në mesjetë	8
	Shqiptarët në fillimet e periudhës moderne (fundi i shek. 14 – shek. XV)	6
	Territoret shqiptare gjatë sundimit osman	5
	Rilindja Kombëtare Shqiptare (1830 – 1912)	6
	Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar 1912– 1924	7
	Konsolidimi i shtetit shqiptar (1925 – 1939)	5
	Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore 1939 – 1944	4
	Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990	8
	Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë	6
	Shqiptarët jashtë kufijve politikë (1912 – sot)	8

Veprimtaritë praktike janë pjesë e rëndësishme e programit. Ato shërbejnë për t'u ardhur në ndihmë nxënësve dhe mësuesve në orët e mësimit dhe atyre të përpunimit të njohurive, me raste sugjerimi për çështje të ndryshme historike, në lidhje me thellimin dhe me përpunimin e njohurive dhe të shprehive të fituara në lëndën e Historisë, duke e vënë nxënësin në qendër për mbledhjen dhe për interpretimin e informacionit.

Nëpërmjet veprimtarive praktike duhet të integrohet historia e qytetërimit të popullit shqiptar me historinë e qytetërimit botëror, duke inkuadruar ngjarjet e historisë së popullit shqiptar në ngjarjet e historisë botërore, nëpërmjet periodizimit të historisë.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- veprimtaritë praktike, të cilat përbëjnë një pjesë integrale të kësaj lënde, krijojnë mundësi për zbatimin e përvojave të të nxënësve në këtë lëndë. Veprimtaritë praktike janë ilustrim praktik i njohurive të fituara nga nxënësit, por njëkohësisht ato i shërbejnë edhe zhvillimit të një sërë aftësive që kanë të bëjnë me mbledhjen, me përpunimin dhe me interpretimin e të dhënave;
- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- projektin kurrikular;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si: e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, si: forcimi i personalitetit, edukimi i karrierës, aftësia për të vendosur në kohë dhe në hapësirë ngjarjet historike, aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak-pasojë, aftësia për të hetuar, për të interpretuar dhe për të parashikuar ngjarje historike, aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptet dhe të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve.

4. INTEGRIMI DHE LIDHJA NDËRLËNDORE

Lënda e Historisë është një nga lëndët bazë të shkencave shoqërore. Njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndët e shkencave shoqërore dhe në lëndët e tjera jashtë fushës së shkencave shoqërore integrohen mjaft mirë me ato të Historisë. Integrimi i tyre mund të shikohet në nivelin e objektivave, të temave, të koncepteve dhe të aftësive.

Lënda e Historisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, Historia mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë objektivat e saj.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e Historisë për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Shembuj të integritit

HISTORI	MATEMATIKË
Për të gjitha linjat e nënlinjat	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kryejnë veprime për llogaritjen e kohës; • të ndërtojnë dhe të interpretojnë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike; • të përdorin numrat e shifrat romake për leximin dhe për shkrimin e shekujve; • të përdorin boshtin numerik për interpretimin e shkallës së kohës. (Vendos në boshtin numerik vitet para dhe pas Krishtit.);
HISTORI	GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojnë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik; • të shprehin opinione, të arsyetojnë, të diskutojnë, të argumentojnë dhe të bëjnë debate argumentuese me tematikë historike;

	<ul style="list-style-type: none"> • të shkruajnë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese me tematikë historike; • të përzgjedhin informacionin e duhur historik në tekst; • të shfrytëzojnë rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik; • të dallojnë në gjinitë e ndryshme letrare: ditarin, kujtimet dhe romanin historik. • të shfrytëzojnë veprat letrare-artistike, si burim informacioni historik. P.sh., nëpërmjet veprës së Homerit, njihen me organizimin shoqëror të jetës në antikitet. “Qytetërimi antik grek në veprën e Homerit”; • të përdorin folklorin shqiptar si burim historik; • të përdorin veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë. “Rilindësit, prodhim i epokës historike shqiptare”.
HISTORI	GJUHË E HUAJ
Për të gjitha nënlinjat	<ul style="list-style-type: none"> • të shfrytëzojnë gjuhën e huaj si burim për interpretimin në gjuhën shqipe të një informacioni historik (p.sh., nxënësve në një veprimtari praktike u kërkohet të gjejnë informacion me tema të caktuara, p.sh.: “Zbulimi i kontinentit afrikan”, duke shfrytëzuar si mjet burimor internetin); • të përdorin terminologjinë bazë historike në gjuhë të huaj. <p>Terminologjia bazë e historisë që i kërkohet anglishtes: History; civilization; state, nation; law; absolute monarchy; constitution; war; king; queen; time; place; religion; government; evidence; World War I/II; empire; expirer; ancient; BC (before Christ); AC (after Christ); medieval; century, ect.</p>

HISTORI	TIK
Për të gjitha nënlinjat	<ul style="list-style-type: none"> • të shfrytëzojnë simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter; • të përdorin Word Processor-in për shkrimin e një materiali historik; • të përdorin PowerPoint-in për prezantimin e një detyre në histori; • të përdorin internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe për figura historike.
HISTORI	GJEOGRAFI
Për të gjitha nënlinjat	<ul style="list-style-type: none"> • të shfrytëzojnë mjetet mësimore gjeografike, si: hartën, globin dhe busullën për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike; • të lexojnë dhe të interpretojë harta të ndryshme historike dhe gjeografike; • të orientohen në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike; • të përcaktojnë në hartë vendndodhjen e qytetërimeve; • të argumentojnë rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve; • të përkufizojnë dhe të shpjegojnë termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërime, gjatë periudhave të ndryshme të historisë; • të tregojnë ç'është mjedisi gjeografik, për të kuptuar ndikimin e tij në zhvillimin e qytetërimeve;

HISTORI	QYTETARIA
Për të gjitha nënlinjat	<ul style="list-style-type: none"> • të përkufizojnë dhe të shpjegojnë konceptet: liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve; • të analizojnë dhe të interpretojnë organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike; • të shpjegojnë dhe të analizojnë format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave historike; • të analizojnë dhe të interpretojnë besimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi) për të shpjeguar rolin e fesë në Histori.
HISTORI	SHKENCA NATYRORE
	<ul style="list-style-type: none"> • të reflektojnë dhe të diskutojnë për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore; • të vlerësojnë rolin qendror të shkencës në botën e sotme; • të kuptojnë karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore; <ul style="list-style-type: none"> ▪ të kuptojnë çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull: çështjen e ngrohjes globale; ▪ të kuptojnë ndikimin e përparimeve teknike në shoqëri, për shembull: ndikimi i internetit.

Autorët e teksteve dhe mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së Historisë, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje, jo vetëm do të ndihmonte në pasurimin e argumenteve dhe burimeve historike, por duke ritheksuar lidhjen e mësimit të Historisë me aspekte të ndryshme të realitetit, do të rriste edhe motivimin e tyre për këtë lëndë.

5. METODOLOGJITË E MËSIMDHËNIES

Përdorimi i një numri të larmishëm rrugësh dhe metodash në mësimin e Historisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit me sukses të kurrikulës së Historisë.

Metodat dhe teknikat e të mësuarit shikohen jo vetëm si një proces didaktik, që pasurohen gjithnjë me elemente të reja, por edhe që duhet të zbatohen në mënyrë krijuese. Gjatë orëve të ndryshme të mësimit, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre. Kështu ndodh me shpjegimin e bisedën, me metodën problemore e kërkimore, stuhia e mendimit, harta e mendimit, loja dhe konkursi etj. Prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit, duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, por edhe me nivelin e nxënësve, gjendjen e bazës didaktike etj.

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje me veçoritë e temave të ndryshme mësimore. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave të lëndës, të parashikuar nga programi mësimor.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren: **shpjegimi**, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive dhe të proceseve historike; **mësimi zbulues** nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre; **biseda**, e cila do të ishte më e

efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv.

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi është një përzierje e shpjegimeve mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre.

Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, ngjarjeve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e Historisë. Gjithashtu, diskutimi është një rast shumë i mirë për të praktikuar të dëgjuarit të nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup.

Mjaft rezultate janë edhe metodat që përfshihen në spektrin e metodave problemore, gjysmëkërkimore e kërkimore, si: mësimi zbulues, veprimtaritë praktike, ekskursionet, projekti mësimor etj. Këto metoda mund të përdoren në ato raste kur nxënësit, në mënyrë individuale ose të organizuar në grupe, ndërmarrin, me ndihmën dhe drejtimin e mësuesit, veprimtari që synojnë zgjidhjen e problemeve të thjeshta etj.

Veprimtaritë praktike dhe projektet kurrikulare janë modele të veprimtarisë mësimore, realizimi i të cilëve kërkon zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, intervista, vrojtimi, studimi i rastit, ndërthurjen e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Këto metoda e vënë theksin te aftësitë dhe te shprehitë.

Studimi i thelluar lehtëson zhvillimin e aftësive historike, në mënyrë të veçantë të aftësisë së punës me fakte dhe punës kërkimore.

Puna me faktet: Studimi i një prej çështjeve përfshin përdorimin e strukturuar të dokumenteve historike. Kjo ndihmon nxënësit të zhvillojë përvojën për vlerësimin e fakteve dhe aftësinë për të formuluar gjykime të arsyeshme.

Studimi kërkimor: Përfshirja në kërkim është pjesë përbërëse e programit të Historisë. Duke u njohur dhe duke u përvetësuar mënyrën se si punojnë historianët, nxënësit zhvillojnë aftësinë për ta zbatuar atë gjerësisht edhe në fusha të tjera.

5.1 Mjetet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënit në lëndën e Historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bëjnë mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa **mjetet e nevojshme didaktike**, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projeksioni, CD, DVD etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv etj.

6. METODAT E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes, që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit, nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi, edhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi i Historisë vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit, aftësitë e tyre për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një ngjarjeje ose figure të caktuar historike. Në lëndën e Historisë, mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup, si dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i Historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në Histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e Historisë është edhe përfshirja

e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje ose figurë të caktuar historike, projekte etj.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes sa më mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në testimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon teste periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pak minutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësit, tek ato njëorëshe; teste me alternativa ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është edhe testimi përfundimtar.

Dosja e nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ajo mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Dosja i përngjan një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar vlerësimin me shkrim ose me gojë.

KLASA 7
35 JAVË X 2 ORË = 70 ORË

LINJA : QYTETËRIMET NË FILLIMET E HISTORISË MODERNE

Orë të sugjeruaraⁱ: 22 ORË

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime mbi ndryshimet në qytetërimet botërore në fillimet e historisë moderne. Ajo përshkruan: humanizmin dhe thelbin e tij; Rilindjen, frymën e saj në art, kulturë, shkencë e në shoqëri; Italinë si qendër të Rilindjes Evropiane; Evropa drejt njohjes së “Botës së Re”; rrethanat historike që nxitën zbulimet gjeografike; në kërkim të rrugëve të reja: zbulimet e mëdha gjeografike; kultura dhe shoqëria vendase (akteke, inke); krijimi i kolonive të para dhe fillimi i sundimit të skllavërisë moderne; pasojat e zbulimeve gjeografike; ndryshimet fetare në Evropë; rrënjët e Reformacionit, doktrina protestante, përfaqësuesit kryesorë; reforma katolike dhe karakteri relativ i saj; Perandoria Osmane dhe Evropa; zgjerimi i Perandorisë Osmane në territoret evropiane dhe ndërprerja e ekspansionit osman në Evropë; ndikimi i qytetërimit osman në Evropë; shoqëria, arti dhe kultura në shek. XVI-XVII; shoqëria, mënyra e jetesës në përputhje me shtresat, pozita e gruas në shoqëri; kultura, arti, shkenca dhe arsimit.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruaraⁱⁱ	Koncepte dhe terma kyç
Humanizmi dhe Rilindja (5 orë)	Në përfundim të klasës së shtatë, nxënësit duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë kushtet 	Humanistët shqiptarë <ul style="list-style-type: none"> • të listojnë humanistët shqiptarë; 	<ul style="list-style-type: none"> • Humanizëm • Rilindje • Zbulimet e mëdha gjeografike

	<p>historike që çuan në lindjen e humanizmit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të listojnë tiparet e humanizmit; • të tregojnë ndryshimet që solli kjo lëvizje; • të përshkruajnë kushtet historike që çuan në periudhën e Rilindjes Evropiane; • të tregojnë ndryshimet e rëndësishme social-kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë dhe ndikimin e saj në Evropë; • të shpjegojnë arsyet e shndërrimit të qyteteve italiane në djepin e qytetërimit modern evropian. 	<ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë njëkohshmërinë e humanizmit shqiptar me atë evropian; • të njohin humanistët tanë, duke vlerësuar veprimtarinë e tyre; • të përshkruajnë kontributin e tyre në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Tomeu, Biçikemi, Gazulli, Maruli, Barleti. 	<ul style="list-style-type: none"> • “Bota e Re” • Koloni • Perandori koloniale • Skllavëri moderne • Reformacion • Kundërreformacion • Konkili i Trentës
<p>Evropa drejt njohjes së “Botës së Re” (5 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë rrethanat që shkaktuan zbulimet e mëdha gjeografike; • të tregojnë në hartë rrugën që përshkuan udhëtarët evropianë në kërkim të “Botës së Re”; • të vlerësojnë kulturën e 	<p>Marko Polo</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë rolin që luajti Marko Polo në lidhjen e Evropës me Kinën; • të shpjegojnë rëndësinë që pati në shkëmbimin e kulturave ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit dhe si 	

	<p>popujve të “Botës së Re”;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojnë rrjedhojat kryesore të këtyre udhëtimeve; • të vlerësojnë krijimin e kolonive të para si parakusht i krijimit të perandorive botërore; • të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e sistemit të skllavërisë moderne. 	<p>frymëzues i zbulimeve të “Botës së Re”.</p> <p>Zbulimi i kontinentit afrikan</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë fazat nëpërmjet të cilave evropianët arritën të njohin kontinentin e Afrikës (njohja bregdetare, njohja e brendshme e kontinentit afrikan); • të shpjegojnë rëndësinë që pati në zhvillimin shoqëror zbulimi i këtij kontinenti. <p>Zbulimi i Australisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë jetën e banorëve vendas (indigjen), gjurmët, kulturën dhe shkëmbimet kulturore; • të përcaktojnë ardhjen e parë të evropianëve në këtë kontinent dhe ndikimin e tyre në jetën e vendasve; • të shpjegojnë kalimin e Australisë në një koloni angleze. 	
<p>Ndryshimet fetare në Evropë (4 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojnë faktorët që sollën përçarjen në besimin katolik; • të tregojnë arsytet pse 	<p>Gjon Buzuku dhe fryma e reformacionit në veprimtarinë e tij</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë dhe të 	

	<p>ndodhi reformati;</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë idetë kryesore të Luterit dhe të Kalvinit; të shpjegojnë veçoritë e reformatit në Angli; të analizojnë pasojat e reformatit protestant në Evropë; të përshkruajnë pasojat që pati reforma katolike në Evropë. 	<p>vlerësojnë kthesën e madhe që bëri Buzuku në tekstet fetare (“Meshari” i Gjon Buzukut).</p> <p>Gjendja fetare e shoqërisë shqiptare gjatë shekujve XVI-XVII</p> <ul style="list-style-type: none"> të përcaktojnë në hartë shtrirjen e riteve ortodokse dhe katolike para pushtimit osman; të vlerësojnë pozicionin e këtyre riteve gjatë pushtimit osman; të shpjegojnë përhapjen e islamizmit në shoqërinë shqiptare; të vlerësojnë tolerancën fetare të shoqërisë shqiptare. 	
<p>Perandoria Osmane dhe Evropa (4 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> Të tregojnë në hartë zgjerimin e Perandorisë Osmane; të tregojnë faktorët që sollën ndërprerjen e ekspansionit osman në Evropë; të vlerësojnë trashëgiminë e qytetërimit osman në art, në kulturë, në shkencë, 	<p>Rezistenca shqiptare ndaj pushtimit osman</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë rezistencën shqiptare ndaj pushtimit osman; të tregojnë momentet kyçe të kësaj rezistencë; të vlerësojnë rolin ndërkombëtar të saj. 	

	në ekonomi dhe në jetën e përditshme.		
Shoqëria, arti dhe kultura në shek. XVI-XVII (4 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë strukturën e shoqërisë evropiane në shek. XVI - XVII; • të përcaktojnë ndryshimet sociale dhe kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë përparimet në teknologji, në art, na arkitekturë dhe në ide; • të evidentojnë kontributin e përparimeve shkencore në shoqërinë evropiane; • të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve që zotëron nxënësi për qytetërimin botëror në fillimet e historisë moderne; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Papa Leoni, Gutenbergu, 	<p>Aspekte të artit, kulturës dhe arsimit në Shqipëri gjatë shekujve XVI-XVII</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë rolin e shkollave klerikale; • të përcaktojnë veçoritë e piktorëve të mëdhenj, si: Onufri, Shpataraku dhe Selenica; • të vlerësojnë arkitekturën e kohës: kështjellat, qytetet dhe objektet e kultit. <p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> • të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve, që zotëron nxënësi mbi qytetërimet në fillimet e historisë moderne. 	

	Erazmi i Roterdamit, Luteri, Kalvini, Leonardo da Vinçi, Mikelanxhelo Buonaroti, Kristofor Kolombi, Vasko de Gama, Magelani, Servantesi, Shekspiri, Galileu, Koperniku, Marlin Barleti, Pal Ëngjëlli, Mikel Maruli, Tomeu, Biçikemi, Gazulli etj.		
--	---	--	--

LINJA: KOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE

Orë të sugjeruara: 48 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstronë njohuri, aftësi, qëndrime mbi sistemin monarkik në Evropë, absolutizmin në Francë, parlamentarizmin në Angli; iluminizmin – shekullin e arsyes; Revolucionin e Parë industrial; faktorët që bënë të mundur Revolucionin Bujqësor dhe Revolucionin Industrial; efektet e ndryshimeve industriale dhe bujqësore në jetën e njerëzve (p.sh.: kushtet e jetesës, punësimit, migrimet etj.); Revolucionin Anglez: Revolucionin e Lavdishëm, triumfin e parlamentarizmit; Revolucionin Amerikan: pavarësinë e kolonive angleze në Amerikën e Veriut; shpalljen e Kushtetutës amerikane; Luftën Civile; Revolucionin Francez: fazat e tij, Deklarata mbi të Drejtat e njeriut dhe qytetarit; periudha Napoloniane e Francës, Evropa pas rënies së Napolonit, Kongresi i Vjenës.

Linja trajton jetën dhe nacionalizmin në Evropën e shekullit XIX; lëvizjet kombëtare dhe mënyrat e ndryshme të krijimit të komb-shteteve të reja (Perandoria Habsburgase, bashkimin e shteteve gjermane dhe italiane); gjithashtu, përshkruan Perandorinë Osmane dhe tkurrjen e saj; Revolucionin e Dytë Industrial; fillesat e demokracisë liberale (Angli, Francë, SHBA, Gjermani), si dhe sistemin kolonial në shekullin XIX.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
Ndryshimet në kulturën	<ul style="list-style-type: none"> Të përshkruajnë konceptin pushtet 	Rilindja Shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> Absolutizëm Iluminizëm

<p>politike dhe në ekonominë evropiane (7 orë)</p>	<p>absolut;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë veçoritë e absolutizmit francez; • të përshkruajnë jetën e përditshme të shoqërisë franceze gjatë sundimit të Luigjit XIV; • të vlerësojnë arritjet në art, në kulturë dhe në shkencë gjatë periudhës së Luigjit XIV; • të tregojnë vlerat e parlamentarizmit anglez; • të përshkruajnë veçoritë karakteristike ndërmjet dy mbretërive (Angli, Francë), duke evidentuar ndryshimet kryesore ndërmjet tyre; • të dallojnë burimet e iluminizmit, duke evidentuar idetë dhe figurat kryesore të tij; • të tregojnë ndikimin e tyre në ndryshimet e jetës së qytetërimeve botërore. 	<ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë ndikimin e iluminizmit në Rilindjen Shqiptare; • të vlerësojnë rilindësit iluministë: Naum Veqilharxhi, Pasko Vasa, Jani Vreto, Naim e Sami Frashëri. 	<ul style="list-style-type: none"> • Parlamentarizëm • Monarki parlamentare • Liberalizëm • Pashallëk • Revolucion i Lavdishëm • Hop • Zhvillim i vrullshëm • Luftë civile • Luftë për pavarësi • Kushtetutë, • Liri, barazi, vëllazëri • Nacionalizëm • Bashkim kombëtar • Shtet i pavarur • Revolucion Industrial
<p>Revolucioni i Parë Industrial</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë faktorët që paraprinë Revolucionin e Parë 	<p>Ndërtimi i një fotomontazhi ku të pasqyrohet ndryshimi që pësoi Evropa në</p>	

(3 orë)	<p>Industrial;</p> <ul style="list-style-type: none"> të shpjegojnë procesin e kalimit nga puna me dorë në atë me makinë; të analizojnë pasojat e këtij revolucioni në jetën evropiane; të përshkruajnë rrjedhjat sociale të Revolucionit të Parë Industrial. 	<p>zhvillimin industrial, bujqësor dhe atë të komunikacionit tokësor dhe detar</p> <ul style="list-style-type: none"> të paraqesin pamje nga makina me avull e Wattit, fabrikave të para, lokomotivave e anijeve të kësaj periudhe etj.; të pasqyrojnë figurat e shpikësve të mëdhenj, si: Wattit, Fultonit etj. 	
Revolucionet: Revolucionit Anglez (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> Të përshkruajnë shkaqet e fillimit të Revolucionit Anglez; të vlerësojnë rëndësinë e Revolucionit të Lavdishëm; të vlerësojnë Aktin mbi të Drejtat e Njeriut; të tregojnë tiparet e qeverisjes pas revolucionit në Angli. 	<p>Shpërbërja e Perandorisë Osmane dhe krijimi i shteteve nacionale në Ballkan</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë revolucionet në Serbi e në Greqi dhe pasojat e tyre; të përcaktojnë në hartë shtetet e reja ballkanike që u krijuan në gjysmën e dytë të shekullit XIX. 	
Revolucioni Amerikan (3 orë)	<ul style="list-style-type: none"> Të përshkruajnë shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; të evidentojnë rolin e Deklaratës së Pavarësisë 	<p>Pashallëqet shqiptare</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë konceptin pashallëk; të përshkruajnë veçoritë kryesore të organizimit të 	

	<p>të kolonive angleze të Amerikës së Veriut;</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë rrisitë e Kushtetutës amerikane në qytetërimin botëror; të tregojnë shkaqet e luftës civile dhe rrjedhojat e saj. 	<p>pashallëqeve shqiptare (Shkodra, Janina).</p> <p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve për ndryshimet në jetën politike ekonomike dhe ndikimin e ideve të reja në to. 	
<p>Revolucioni Francez (7 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> Të tregojnë shkaqet e shpërthimit të Revolucionit në Francë; të vlerësojnë rolin e Deklaratës mbi të "Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit"; të përshkruajnë idetë e reja të Revolucionit Francez; të përshkruajnë reformat kryesore të periudhës së Napolonit; të përcaktojnë vendimet e Kongresit të Vjenës. 		

<p>Jeta dhe nacionalizmi në Evropën e shekullit XIX (7 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë konceptin nacionalizëm; • të tregojnë shkaqet e lindjes së nacionalizmit dhe përhapjen e tij në Evropë (Perandorisë Habsburgase e Perandoria Osmane (në Ballkan) dhe shtetet gjermane e italiane); • të përshkruajnë lëvizjet nacionale në Perandorinë Habsburgase, në shtetet gjermane dhe në Perandorinë Osmane (në Ballkan); • të tregojnë për ndryshimet që pësoi arti dhe kultura nga ndikimin i nacionalizmit në Evropë. 	<p>Nacionalizmi shqiptar gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë fillimin e nacionalizmit shqiptar; • të vlerësojnë platformën politike të Lidhjes së Prizrenit; • të analizojnë kalimin nga autonomi në pavarësi. <p>Hapja e shkollave shqipe</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë rolin e dijeve dhe të shkollës në forcimin e frymës kombëtare, si kërkesë themelore e kohës; • të përshkruajnë rolin që pati hapja e shkollës së parë shqipe në krijimin e sistemit arsimor shqiptar. <p>Roli i shoqërive patriotike të diasporës shqiptare</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë rolin e shoqërive patriotike të diasporës shqiptare në: Rumani, Turqi, Itali, SHBA. 	
--	---	--	--

<p>Perandoria Osmane dhe tkurrja e saj (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë tiparet e krizës së Perandorisë Osmane; • të dallojnë përpjekjet e Perandorisë Osmane për daljen nga kriza nëpërmjet reformave; • të përcaktojnë rrymat nacionaliste në Perandorinë Osmane; • të shpjegojnë shkaqet e rënies së Perandorisë Osmane. 	<p>Kryengritjet shqiptare kundër sundimit osman 1909 – 1912</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë veçoritë e kryengritjeve të viteve 1909-1910; • të vlerësojnë • kryengritjen e vitit 1912; • të përcaktojnë rolin që luajti kryengritja e vitit 1912 si prag i shpalljes së Pavarësisë. 	
<p>Industrializimi dhe qytetërimi botëror: Revolucionin e Dytë Industrial (4 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë përparimin e madh të sektorit industrial (çeliku, nafta energjia elektrike etj.); • të vlerësojnë Revolucionin e Dytë Industrial si shprehje e ndryshimeve të mëdha që pësoi shoqëria në gjysmën e dytë të shekullit XIX; • të listojnë zbulimet e mëdha shkencore të kohës dhe rëndësinë e tyre. 	<p>Ndërtimi i një fotomontazhi ku të pasqyrohen të gjithë elementët e Revolucionit të Dytë Industrial</p> <ul style="list-style-type: none"> • të paraqesin pamje nga fabrika ku përdoret energjia elektrike, hidrocentrale dhe termocentrale, uzina të prodhimit të automobilave etj; • të njihen me figurat e shquara të shkencës: Edisoni, vëllezërit Rai, Pasteri, Mari dhe Pier Kyri etj. 	

		<p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> • të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve ndaj lëvizjeve nacionale që sollën shtetet e pavarura; • të tregojnë ndryshimet që pësoi Perandoria Osmane. 	
<p>Fillesat e demokracisë liberale (Angli, Francë, SHBA, Gjermani) (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë lëvizjen qytetare për të drejtën elektorale, çështjet punëtore dhe institucionalizimin e partive politike si fillesa të demokracisë liberale në Evropë dhe në SHBA. 	<p>Demokracia liberale në ambientin tonë shkollor</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë lirinë e fjalës, të shtypit, të organizimit, të fesë, të kulturave të ndryshme etj • të përcaktojnë pozicionin e djalit dhe të vajzës në ambientet shkollore dhe në organizmat vendimmarrës. 	
<p>Sistemi kolonial në shekullin XIX (3 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojnë konceptin kolonializëm; • të shpjegojnë faktorët e shtrirjes së sistemit kolonial dhe pasojat e tij; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Luigji XIV, Volter, Loku, Ali Pasha, Bushatlinjtë, 	<p>Kolonitë dhe vlerësimi i tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë vlerat e burimeve të këtyre kolonive për vendet kolonizatore (burim për lëndët e para, burim për investime); • të përshkruajnë ndikimin që pati kolonizimi në 	

	<p>Oliver Kromwell, Xheferson, Washington, Linkoln, Robespierin, Napoleoni, Bismarku, Mançini, Kavuri, Garibaldi etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve që zotëron nxënësi për tematikën “Koha e ndryshimeve thelbësore”. 	<p>zhvillimin e shoqërive të kolonizuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> të ndërtojnë një fotomontazh “Jeta në kolonitë e Azisë, e Afrikës dhe të Amerikës Latine”. 	
--	--	--	--

KLASA 8
35 JAVË X 2 ORË = 70 ORË

LINJA: PERIUDHA TRONDITJEVE TË MËDHA (1914-1945)

Orë të sugjeruara: 32 ORË

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime mbi Luftën e Parë Botërore: rritjen e tensioneve, krijimin e dy aleancave kundërshtarë politike dhe ushtarake (Antanta dhe Blloku Qendror); shkaqet dhe pretekstin e luftës; përfundimin dhe pasojat e luftës; Konferencën e Paqes dhe Lidhjen e Kombeve; sistemet politike midis dy luftërave: totalitarizmi komunist e fashist; vendosjen e regjimit komunist në BRSS; Italinë fashiste dhe Gjermaninë naziste; ekonominë në periudhën midis dy luftërave botërore: sistemet ekonomike dhe

veçoritë e tyre; krizën e madhe ekonomike 29"-30", shkaqet dhe pasojat e saj; kapërcimin e krizës nga demokracitë kryesore perëndimore 1918 – 1939 (Anglia, Franca dhe SHBA); shoqërinë artin dhe kulturën: ndryshimet shoqërore pas luftës; rritjen e rolit të shoqërisë, forcimin e rolit të rinisë, të gruas, të intelektualëve dhe të punëtorëve; tiparet e reja të artit dhe të kulturës në të dyja sistemet.

Linja trajton gjithashtu, Luftën e Dytë Botërore: krijimin e blloqeve ushtarake; shkaqet e Luftës së Dytë Botërore, karakterin e saj, zhvillimin dhe përfundimin e luftës; pasojat e Luftës së Dytë Botërore.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyç
<p>Lufta dhe paqja 1914-1920 (7 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë aleancat politike e ushtarake në prag të luftës; • të shpjegojnë rritjen e tensionit në Evropë, duke evidentuar shkaqet e Luftës së Parë Botërore; • të evidentojnë ndryshimin midis shkaqeve dhe pretekstit të luftës; • të tregojnë rrjedhojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të luftës; • të analizojnë vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes; • të pasqyrojnë arsyet dhe rëndësinë e krijimit të Lidhjes së Kombeve. 	<p>Shqipëria gjatë viteve 1914 – 1918</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë gjendjen e Shqipërisë gjatë viteve 1914 -1918. <p>Reagimi i shqiptareve gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë rrethet patriotike shqiptare; • të pasqyrojnë objektivat themelore të LKSH-së; <p>Traktati i Fshehtë i Londrës</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë karakterin e këtij traktati; • të evidentojnë vendimet e tij për Shqipërinë. <p>Një Evropë më e ndarë dhe më e varfër</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë rivalitetet ndërmjet fuqive të mëdha 	<ul style="list-style-type: none"> • Aleancë • Blloqe • Konferenca e Paqes • Lidhja e Kombeve • “Vatra” • Totalitarizëm • Fashizëm • Komunizëm • Nazizëm • Qytetërim perëndimor • Demokraci liberale SHMS • Kursi i Ri i Rusveltit • Tregues social

		<p>evropiane: ekonomike, territoriale;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë ndikimin e këtij rivaliteti në jetën ekonomike, politike, sociale evropiane. <p>Armëpushim 20-vjeçar, jo paqe</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojnë arsyet pse u quajt paqe e rreme. <p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> • të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve për vlerësimin e trashëgimisë së Luftës së Parë Botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore në qytetërimin botëror. 	
<p>Sistemet politike midis dy luftërave botërore (7 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojnë saktë konceptet: komunizëm, fashizëm, totalitarizëm, diktaturë; • të evidentojnë sistemet kryesore politike në vitet 1920-1939; 	<p>Jeta politike e shoqërore në Shqipëri në vitet 1928-1939</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë ecurinë politike shqiptare drejt stabilizimit shtetëror; • të analizojnë lëvizjet 	

	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë shkaqet e ardhjes në pushtet të qeverisjeve totalitare; • të portretizojnë figurat totalitare të Stalinit, të Musolinit, të Hitlerit; • të përshkruajnë tiparet kryesore të politikës së brendshme e të jashtme në BRSS, në Itali e në Gjermani. 	<p>shqiptare në fushën shoqërore-arsimore në vitet 1925-1939.</p> <p>Jeta qytetare shqiptare në vitet ‘30</p> <ul style="list-style-type: none"> • të portretizojnë qytetin shqiptar; • të përshkruajnë ndikimet e jetës moderne evropiane në qytetin shqiptar të viteve ‘30; • të ndërtojnë një album fotografik të kohës. <p>Republika dhe monarkia shqiptare</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojnë ndryshimet ndërmjet republikës dhe monarkisë; • të identifikojnë figurat historike të kohës, duke evidentuar rolin e tyre në jetën politike shqiptare; • të pasqyrojnë, nëpërmjet një albumi, ngjarjet kryesore historike 	
--	--	--	--

		<p>Agresiviteti i pushteteve totalitare dhe qëndrimi i demokracive liberale</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë aktet agresive të fashizmit italian dhe nazizmit gjerman në politikën e brendshme dhe të jashtme; të vlerësojnë qëndrimin pacifist të shteteve demokratike liberale. 	
<p>Ekonomia në periudhën midis dy luftërave botërore (7 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> Të përcaktojnë këto koncepte e terma historikë: qytetërim perëndimor, demokraci liberale; të përshkruajnë problemet ekonomike pas Luftës së Parë Botërore; të evidentojnë shkaqet dhe pasojat e krizës 1929-1933; të tregojnë politikat e ndryshme që ndërморën Anglia, Franca dhe SHBA-të për të dalë nga kriza ekonomike: shteti i mirëqenies në Angli, Fronti Popullor në Francë, marrëveshja e re (Kursi i Ri i Rusveltit në SHBA). 	<p>Monarkia shqiptare dhe kriza botërore</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë veçoritë kryesore të monarkisë shqiptare gjatë krizës. <p>Ese: Totalitarizmi evropian „22-„39 (nxënësi u referohet vetëm njërit prej shteteve totalitare).</p> <p>Fotomontazh: Aspekte të totalitarizmit evropian.</p> <p>Fryma totalitariste dhe shkolla</p> <ul style="list-style-type: none"> të tregojnë ndikimin e ideologjisë totalitare në fushën e edukimit. 	

<p>Shoqëria arti dhe kultura midis dy luftërave botërore (5 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë ndryshimet sociale e kulturore që pësoi shoqëria në periudhën midis dy luftërave botërore; • të përshkruajnë tiparet social-kulturore të shoqërive totalitare (komuniste, fashiste, naziste); • të dallojnë ndryshimet ndërmjet tipareve të shoqërive totalitare me ato të shoqërive demokratike; • të tregojnë shkaqet, synimet dhe arritjet e lëvizjeve sociale në qytetërimet perëndimore; • të evidentojnë karakteristikat e artit dhe të kulturës gjatë gjysmës së parë të shek. XX. 	<p>Diskutim për jetën e Shqipërisë në vitet ‘30 nëpërmjet filmit “Koncert në vitin ,36”</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë mënyrën e jetesës së shoqërisë shqiptare në vitet ‘30 • të evidentojnë figurën e këngëtares Tefta Tashko Koço dhe kontributin e saj në art; • të shqyrtojnë një sërë interpretimesh të së kaluarës për personazhet e këtij filmi për të vlerësuar vlefshmërinë objektive të figurave të tyre sot nën dritën e fakteve të reja. <p>Shtypi shqiptar në vitet ‘30</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojnë pluralizmin në shtypin e kohës. 	
<p>Lufta e Dytë Botërore (1939-1945) (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të dallojnë blloqet kryesore ushtarake në prag të Luftës së Dytë Botërore; • të tregojnë shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; 	<p>Deklaratat e tri fuqive aleate për njohjen e luftës së popullit shqiptar</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë rëndësinë e deklaratave të aleatëve për luftën e popullit shqiptar. 	

	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; • të shpjegojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore: pasojat ekonomike, pasojat sociale, pasojat psikologjike; • të evidentojnë figurat kyçe që luajtën rol të rëndësishëm në ngjarjet historike të periudhës 1939 – 1945; • të vlerësojnë dhe të provojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve, që zotëron nxënësi për ngjarjet historike të ndodhura gjatë dhe ndërmjet dy luftërave botërore; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Willson, At Gjergj Fishta, Stalini, Musolini, Hitleri, Fan S. Noli, Ahmet Zogu, Rusvelti, Lorca, Sartri, Tefta Tashko Koço, Gjergj Fishta, Çurçilli, 	<p>Shqipëria në periudhën e Luftës së Dytë Botërore</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë rezistencën antifashiste gjatë viteve „39-“41; • të përshkruajnë organizimin e luftës së armatosur gjatë viteve „42-“44; • të përshkruajnë rolin e nacionalistëve dhe të komunistëve gjatë luftës; • të shpjegojnë pasojat e marrëveshjes së Mukjes; • të tregojnë rolin e qeverive shqiptare gjatë pushtimit italian dhe gjerman; <p><i>(mësuesi është i lirë të përzgjedhë një nga temat e mësipërme ose mund të japë dy – tri tema duke e organizuar klasën në grupe)</i></p> <p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> • të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve për ngjarjet 	
--	---	---	--

	Mit'hat Frashëri, Enver Hoxha, Abaz Kupi etj.	gjatë dhe midis dy luftërave botërore në aspektin politik, ekonomik, social dhe kulturor.	
LINJA: QYTETËRIMET E SOTME BASHKËKOHORE (1945 – SOT)			
Orë të sugjeruara: 38 orë			
<p>Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime mbi periudhën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946); Konferencën e Paqes; krijimin e OKB-së, arsyet dhe qëllimin e saj; rrjedhojat e Luftës së Dytë Botërore.</p> <p>Linja trajton rimëkëmbjen e ekonomisë evropiane pas Luftës së Dytë Botërore; Luftën e Ftohtë: fillimin e Luftës së Ftohtë, rolin e dy superfuqive; organizimin e bllokut perëndimor dhe atij komunist. Veçoritë e ekonomisë në shtetet e bllokut komunist; veçoritë e ekonomisë në shtetet e bllokut perëndimor; Revolucionin e Tretë Industrial, ndikimin e tij në zhvillimet ekonomike e shoqërore botërore. Nëpërmjet kësaj linje nxënësit aftësohen për shoqërinë artin, kulturën dhe arsimin në Evropën e viteve 1945 – 1990; ndryshimet në strukturën shoqërore dhe në mënyrën e jetesës; lëvizjet sociale në Evropë e në SHBA-së. Zhvillimet e reja në art, në kulturë, në shkencë dhe në arsim.</p> <p>Përfundimin e Luftës së Ftohtë: shndërrimet në Bashkimin Sovjetik; shembjen e Murit të Berlinit dhe revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore; ndryshimet e hartës politike të Evropës në përfundim të Luftës së Ftohtë.</p> <p>Kjo linjë zhvillon dhe hapat e mëtejshëm drejt integritimit evropian; prirjet e qytetërimeve sot: jetën e përditshme në qytetërimet e sotme; revolucionin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; teknologjinë dhe mjedisin; globalizimin.</p>			
Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946) (3 orë)	<ul style="list-style-type: none"> Të tregojnë vendimet e Konferencës së Paqes, duke evidentuar ndryshimet që ato sollën në botën e pasluftës; të përshkruajnë karakterin dhe qëllimet e OKB-së; të përcaktojnë karakteristikat e ekonomisë së pas luftës; të vlerësojnë rolin e 	<p>Shqipëria menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946)</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë gjendjen ekonomike politike të Shqipërisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. 	<ul style="list-style-type: none"> Konferencë e Paqes OKB Bashkekzistencë Paqësore Çmilitarizim Komitete për të Drejtat e Njeriut Armë bërthamore Garë armatimesh Globalizëm Hipi Liberalizëm modern

	<p>programit ekonomik UNRRA dhe Planit Marshall në rindërtimin e Evropës së pas luftës.</p>		<ul style="list-style-type: none"> • Ekonomi mikse • Neoliberalizëm • Shoqëri e konsumit • Modeli sovjetik • Luftë e Ftohtë • Blloqe ushtarake • NATO • Traktati i Varshavës • Plani Marshall • KNER • Lëvizje sociale • Revolucion i Tretë Shkencor • Gllasnost • Perestrojkë • Revolucion Demokratik • Bashkim Evropian • Integrim • Bashkim monetar • Euro • Globalizim • Revolucioni Informatik • Teknologji ekologjike
<p>Lufta e Ftohtë (5 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përdorin saktë termat dhe konceptet historike kyçe: Luftë e Ftohtë, Perde e Hekurt, superfuqi; • të përshkruajnë shkaqet e fillimit të Luftës së Ftohtë; 	<p>Shteti shqiptar dhe politikat e jashtme gjatë Luftës së Ftohtë</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA-në 	

	<ul style="list-style-type: none"> • të evidentojë drejtimet kryesore të Luftës së Ftohtë; • të tregojnë qëllimin e krijimit të blloqeve ushtarake (NATO dhe Traktati i Varshavës). 	<p>dhe Britaninë e Madhe;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë arsyet e tensionimit e marrëdhënieve me shtetet perëndimore; • të përshkruajnë faktorët që shkaktuan ndryshimet në politikën e jashtme shqiptare; • të gjykojnë mbi mospajtimin e PPSH-së me Kursin e Ri të Nikita Hrushovit. 	
Ekonomia (6 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë tiparet kryesore të organizimit ekonomik të shteteve perëndimore dhe lindore; • të shpjegojnë arsyet dhe rrugët drejt integritit ekonomik-politik të shteteve të bllokut perëndimor (Komuniteti Evropian i Çelikut dhe i Qymyrit, Komuniteti Ekonomik Evropian); • të përshkruajnë tiparet kryesore të organizimit ekonomiko-politik të shteteve të bllokut komunist (KNER); • të evidentojnë arsyet e bumit ekonomike në shtetet 	<p>Izolimi i Shqipërisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë modelin • socialist të ekonomisë shqiptare dhe tiparet e tij (industrializimi, kolektivizimi etj. <p>Shqipëria anëtare e OKB-së</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë përpjekjet e qeverisë shqiptare për njohjen e saj. <p>Revolucioni i Tretë Industrial</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë ndryshimet që i solli njeriut ky revolucion në shpejtësinë e komunikimit dhe në 	

	<p>e bllokut perëndimor, duke e krahasuar me zhvillimin ekonomik në bllokun komunist;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë prirjet e Revolucionit të Tretë Industrial (elektronik); • të analizojnë ndikimin që pati Revolucioni i Tretë Industrial në perspektivën ekonomike shoqërore të botës. 	<p>përgatitjen për një botë globale.</p>	
<p>Shoqëria, arti, kultura dhe arsimiti në Evropën e viteve 1945 – 1990 (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë ndryshimet sociale e kulturore që pësoi shoqëria evropiane në periudhën 1945 – 1990, duke krahasuar zhvillimet e shoqërisë në vendet kapitaliste me ato në vendet komuniste; • të përshkruajnë mënyrën e jetesës në shoqërinë evropiane të viteve 1945 – 1990, në plan krahasues mes vendeve kapitaliste e komuniste; • të pasqyrojnë lëvizjet sociale në Evropë duke vlerësuar arritjet e tyre (lëvizja feministe, lëvizja e 	<p>Ideologjizimi i arsimit, i artit dhe i kulturës në Shqipëri në vitet 1945 – 1990</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë politikat arsimore të shtetit komunist; • të evidentojë themelimin e institucioneve arsimore dhe kulturore; • të listojnë disa prej figurave më të rëndësishme historike gjatë viteve „45-„90. <p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> • të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe 	

	<p>të rinjve, lëvizja kundër diskriminimit racial);</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojnë tiparet e reja që manifestoi arti, kultura, shkenca dhe arsimit në Evropën e viteve 1945 – 1990; • të njohin disa nga figurat kyçe që luajtën rol të rëndësishëm në ngjarjet historike të periudhës 1945 – 1990, si p.sh.: Kenedi, De Gol, Regan, Klinton, Theçer, Çurçill, Hrushov, Gorbaçov. 	<p>të qëndrimeve për ngjarjet pas Luftës së Dytë Botërore.</p>	
<p>Fitorja e demokracisë. Përfundimi i Luftës së Ftohtë (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përdorin saktë termat dhe konceptet historike kyçe: revolucion demokratik, gllasnost, perestrojkë; • të përshkruajnë ngjarjet që shënuan përfundimin e Luftës së Ftohtë; • të evidentojnë krizën e dështimit të sistemeve komuniste në Evropën Qendrore dhe Evropën Lindore; • të pasqyrojnë lëvizjet antikomuniste që çuan në 	<p>Republika e pavarur e Kosovës si shteti më i ri në botë</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë rrugën e zhvillimit historik që ka kaluar Kosova drejt pavarësisë; • të argumentojnë ndikimin e institucioneve ndërkombëtare në krijimin e shtetit të Kosovës; • të evidentojnë ndryshimet gjeografike-politike në rajon pas pavarësisë së Kosovës. 	

	<p>transformimin e shteteve komuniste në shoqëri demokratike;</p> <ul style="list-style-type: none"> të evidentojnë në hartën politike të Evropës, ndryshimet territoriale të pas Luftës së Ftohtë (Bashkimi i Gjermanisë, shpërbërja e Jugosllavisë dhe procesi i pavarësisë së Kosovës). 		
<p>Bashkimi Evropian (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> Të evidentojnë Traktatin e Mاستrihtit, si vazhdues të procesit të integrimit evropian dhe krijuesin e Bashkimit Evropian; të vlerësojnë rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian; të listojnë në mënyrë skematike institucionet kryesore vendimmarrëse të Bashkimit Evropian, duke evidentuar misionin e tyre; të analizojnë zgjerimin e procesit të integrimit euro-atlantik në shtetet ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore; të analizojnë integrimin rajonal si proces ndihmës i integrimit evropian. 	<p>Shqipëria në rrugën e integrimit euro-atlantik</p> <ul style="list-style-type: none"> të përcaktojnë marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Evropian; të tregojnë marrëveshjen e stabilizim-asocimit si hap i rëndësishëm drejt integrimit evropian; të evidentojnë anëtarësimin e Shqipërisë në NATO; të diskutojnë në lidhje me synimet dhe detyrimet e Shqipërisë në MSA(Marrëveshja Stabilizim-Asocim). 	

		<p>Integrimi i popujve që dolën nga sistemi komunist në NATO dhe në BE</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë vendosjen në vendet ish-komuniste; • të përcaktojnë orientimin e ri të politikës së jashtme të këtyre vendeve; • të listojnë rrugën kronologjike të përfshirjes së këtyre vendeve në KSBE, në NATO dhe në BE; • të vlerësojnë rëndësinë e integrimit në këta organizma. 	
<p>Prirjet e qytetërimeve sot (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të evidentojnë lëvizjet e reja sociale; • të përcaktojnë ndryshimet që solli në jetën ekonomike dhe shoqërore Revolucioni i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit; • të diskutojnë kuptimin e ndotjes së mjedisit; • të evidentojnë drejtimet dhe përfitimet e vendeve të ndryshme nga globalizimi; • të përshkruajnë format dhe 	<p>Shqipëria drejt përdorimit të energjive të rinovueshme</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë burimet aktuale të rinovueshme të energjisë; • të evidentojnë kapacitetin e Shqipërisë për përdorim të energjive të rinovueshme (turbinat e erës, panelet solare, hidrocentralet). <p>Ese: Jetohet më mirë dhe konsumohet më shumë</p>	

	<p>mënyrat e ndryshme të jetesës në qytetërimet e sotme, duke gjykuar mbi raportet trashëgimi dhe tendencat e reja sot;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë tiparet dhe prirjet e reja të artit, kulturës dhe arsimit; • të evidentojnë prirjet e zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë drejt zbulimit të kozmosit, modernizimit dhe automatizimit të jetës; • të vlerësojnë dhe të provojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve, që zotëron nxënësi për ngjarjet historike të ndodhura gjatë periudhës 1945-1990; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Harri Truman, Xhorxh Marshall, Voslav Havel, Les Valesa, Mihal Gorbaçov, Nikita Hrushov, Xhorxh Bush, Leonida Brezhnjevi, 	<p>ose</p> <p>Bota sot një qendër globale</p> <p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> • të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve mbi prirjet e qytetërimeve pas Luftës së Ftohtë dhe hapave drejt integritimit evropian. 	
--	---	---	--

	Bernard Kushne, Zhan Mone, Adenauer, Aliçe de Gasper, Theçer, Çurçill, Kenedi, De Gol, Regan, Klinton, Ibrahim Rugova, Adem Jashari etj.		
--	--	--	--

KLASA 9
35 JAVË X 2 ORË = 70 ORË

LINJA: PARAHISTORIA DHE ANTIKITETI NË TERRITORET SHQIPTARE

Orë të sugjeruara: 7 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstronë njohuri, aftësi, qëndrime mbi periudhën parahistorike dhe avancimin e kulturave të para në territoret shqiptare dhe në Ballkanin Perëndimor. Nëpërmjet kësaj linje nxënësit do të njihen me kushtet e jetesës së njerëzve në periudhën e gurit, ndryshimet e këtyre kushteve si rezultat i shpikjes së bronzit dhe hekurit. Kjo linjë do t'i pajisë nxënësit me njohuri dhe me shprehje për ilirët dhe qytetërimin e tyre, shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror, kulturën ilire dhe ndikimi e kulturave fqinje greke dhe romake në territorin ilir.

Veprimtaritë praktike kanë për qëllim të vendosin nxënësin në pozitën e një historiani, si një zbulues (eksplorues) dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, përzgjedhës, gjurmues (hulumtues) e vlerësues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
Periudha parahistorike (3 orë)	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> të identifikojnë ekzistencën e kulturave parahistorike në territoret 	<p>Parahistoria evropiane dhe ajo protoilire</p> <ul style="list-style-type: none"> të identifikojnë të dhënat historike evropiane dhe ato protoilire; 	<ul style="list-style-type: none"> Paleolit Neolit Palafite Paleo-indoevropian Matriarkat Patriarkat

	<p>shqiptare, në Ballkanin Perëndimor dhe avancimin e këtyre kulturave;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë në hartë qendrat e banuara prehistorike në territoret e Ballkanit Perëndimor; • të përshkruajnë mënyrën e jetesës në parahistori; • të shpjegojnë ndryshimet që solli lindja e bujqësisë në jetën e njeriut. 	<ul style="list-style-type: none"> • të gjejnë të përbashkëtat dhe ndryshimet duke krahasuar këto të dhëna. <p>Veçoritë e organizimit shoqëror: matriarkati dhe patriarkati</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë shoqërinë në matriarkat dhe në patriarkat; • të shpjegojnë ndryshimin e shoqërisë nga matriarkati në patriarkat; • të evidentojnë shkaqet dhe pasojat e këtij ndryshimi. <p>Ndikimi i kulturave fqinje greke dhe romake në kulturën ilire</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë ndryshimet që pësoi jeta dhe kultura ilire nga ndikimi i kulturave fqinje greke dhe romake; • të përshkruajnë disa nga ndryshimet e jetës qytetare në Iliri gjatë sundimit romak. 	<ul style="list-style-type: none"> • Autokton • Tuma • Pellazgë • Bazileu • Koinon (bashkësi qytetare) • Mbretër, • Mbretëri • Dinasti • Konfederatë • Federatë • Simahi • Republikë
--	---	--	--

		<p>Simbolika ilire dhe përmbajtja e saj</p> <ul style="list-style-type: none"> • të listojnë disa nga simbolet e përdorura nga ilirët; • të përshkruajnë kuptimin e tyre duke diskutuar vazhdimësinë e tyre. 	
<p>Qytetërimi ilir (4 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë në hartë vendndodhjen e ilirëve në Gadishullin e Ballkanit; • të përcaktojnë në hartë shtrirjen e fiseve kryesore ilire; • të përshkruajnë veçoritë kryesore të fiseve ilire; • të përshkruajnë format kryesore të organizimit shtetëror në territoret ilire (konfederata fisnore dhe mbretëritë ilire); • të listojnë dinastitë kryesore të mbretërive ilire dhe drejtuesit e këtyre dinastive; • të vlerësojnë kontributin e tyre në zhvillimin e qytetërimit ilir; • të përshkruajnë gjendjen 		

	<p>ekonomike e shoqërore të fiseve ilire nga shek. V deri në shek. II para Krishtit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë mënyrën e jetesës së shoqërisë ilire; • të rendisin disa të dhëna për kulturën ilire, gjuhën simbolet shtetërore, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët, praktikat e varrimit dhe besimin; • të përcaktojnë pozitën e Ilirisë në Perandorinë Romake; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Bardhyli, Glaukias, Monun, Agroni, Teuta, Pirro, Genti, Longari, Bato etj. 		
--	---	--	--

LINJA: TERRITORET ARBËRORE NË MESJETË

Orë të sugjeruara: 8 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstronë njohuri, aftësi, qëndrime: mbi territoret arbërore në mesjetë. Kjo linjë ka për qëllim të shpjegojë vazhdimësinë ilire-arbërore-shqiptare, ndarjen e Perandorisë Romake dhe pasojat e kësaj ndarjeje për territoret shqiptare, dyndjet e sllavëve në territoret shqiptare dhe pasojat e tyre. Linja përshkruan karakteristikat kryesore të principatave arbërore gjatë shek. XII- XIV (Principata e Arbrit, Balshajt, Topiajt, principatat e Shqipërisë së poshtme); ndryshimet kryesore që solli zhvillimi i marrëdhënieve feudale në territoret arbërore. Njëpërmjet kësaj linje nxënësit njihen me karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore me kulturën, me artin dhe me shoqërinë arbërore në mesjetë.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
<p>Arbëria në mesjetë (8 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë origjinën e emrit Arbëri; • të evidentojnë të dhënat historike dhe arkeologjike që tregojnë vazhdimësinë ilire-arbërore-shqiptare; • të përcaktojnë në hartë shtrirjen e Principatave Arbërore shek. XII-XIV; • të evidentojnë rolin e Principatës së Arbrit si sundim dinastie; • të përshkruajnë veçoritë e principatave shqiptare gjatë shek. XIV; • të dallojnë ndryshimet ndërmjet tyre; • të përshkruajnë ndryshimet kryesore që solli zhvillimi i marrëdhënieve feudale në territoret arbërore; • të analizojnë veçoritë politike dhe ekonomike të sistemit feudal në Arbëri; • të përcaktojnë në hartë 	<p>Dyndjet e sllavëve në territoret shqiptare, pasojat e tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë pasojat e dyndjeve sllave në Ballkan dhe territoret shqiptare. <p>Territoret shqiptare pas ndarjes së Perandorisë Romake</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë pozitën e territoreve shqiptare pas ndarjes së Perandorisë Romake. <p>Kultura, arti, arsimit, letërsia në mesjetë, në shek. XII-XV</p> <ul style="list-style-type: none"> • të rendisin disa të dhëna për kulturën arbërore, si: gjuhën, simbolet shtetërore, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët etj; • të përshkruajnë disa nga aspektet e zhvillimit të arsimit, të letërsisë, të artit dhe të fesë në mesjetë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Asimilim • Arbër • Sllavë • Principatë • Kodikë • Pronja • Bashtina • Statut • Kultura e Komanit

	<p>qytetet kryesore arbërore mesjetare;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë karakteristikat e qyteteve mesjetare në territoret arbërore; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Progoni, Gjini, Dhimitri, Gjin Bue Shpata, Karl Topia, Vëllezërit Balshaj. 	<p>Pushtimi norman, anzhuin dhe serb në Arbëri</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë shkaqet e ekspeditave ushtarake të normanëve në Arbëri, duke evidentuar pasojat e tyre; • të përshkruajnë sundimin anzhuin në territoret arbërore dhe veçoritë e politikës së tyre. <p>Despotati i Epirit dhe vazhdimi i sundimit bizantin në Arbëri</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë krijimin e despotatit të Epirit si shenjë dobësimi e Perandorisë Bizantine; • të përcaktojnë ecurinë historike të despotatit; • të përcaktojnë faktorët e rënies së despotatit dhe rivendosjes së sundimit bizantin. 	
--	--	---	--

LINJA: SHQIPTARËT NË FILLIMET E PERIUdhËS MODERNE

(FUNDI I SHEK. 14 – SHEK. XV)

Orë të sugjeruara: 6 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime: mbi gjendjen e territoreve arbërore në prag të pushtimit osman. Ajo evidenton momentet kryesore të ardhjes së osmanëve në territoret arbërore dhe qëndrimin e princërve arbëror; ardhjen e Skënderbeut në Arbëri, bashkimin e princërve arbëror, Kuvendin e Lezhës, rëndësinë e tij. Linja prezanton momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut, organizimin e shtetit të Skënderbeut, jetën, marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera, situatën e Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut dhe rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
<p>Arbëria nga fundi i shek. 14 – shek. 15 (2 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë gjendjen e territoreve arbërore në prag të ardhjes së osmanëve në Ballkan; të tregojnë qëndrimin e princërve arbërorë gjatë pushtimit osman. 	<p>Ballkani nën pushtimin osman</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë gjendjen e territoreve të Ballkanit në prag të pushtimit osman; të evidentojnë qëndrimin e princërve të Ballkanit kundër pushtimit osman; <p>Vizitë në Muzeun e Krujës</p> <ul style="list-style-type: none"> të njihen nga afër me kryeqendrën e shtetit të Arbrit gjatë periudhës së Skënderbeut; të identifikojnë objektet kryesore historike duke u njohur nga afër me organizmin e shtetit gjatë 	<ul style="list-style-type: none"> Sanxhak Mirie Besëlidhje Timar Ferman Sanxhak bej

		<p>periudhës së Skënderbeut;</p> <ul style="list-style-type: none"> të dallojnë dhe të rendisin simbolet e shtetit arbëror. <p>Politika e jashtme e Skënderbeut</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet e tjera. <p>Test</p> <p>të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve për qytetërimin ilir e organizimin e tij, si dhe vazhdimësinë ilire arbërore, shqiptare.</p>	
<p>Epoka e Gjergj Kastriot Skënderbeut (4 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut. të shpjegojnë arsyet e thirrjes së kuvendit të Lezhës; të listojnë vendimet e kuvendit të Lezhës duke evidentuar rëndësinë e 		

	<p>tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • të rendisin betejat kryesore nën drejtimin e Skënderbeut; • të përshkruajnë tiparet e shtetit nën drejtimin e Skënderbeut; • të vlerësojnë aftësinë e Skënderbeut në formimin e shtetit; • të përshkruajnë jetën e shoqërisë arbërore gjatë periudhës së Skënderbeut; • të evidentojnë rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Gjon Kastrioti, Gjergj Araniti, Hamza Kastrioti, Gjergj Kastriot Skënderbeu etj. 		
--	---	--	--

LINJA: TERRITORET SHQIPTARE GJATË SUNDIMIT OSMAN

Orë të sugjeruara: 5 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime: mbi ndryshimet ekonomike dhe shoqërore të shqiptarëve nën sundimin osman (timar, qytetet, islamizimi, kultura, arsimit); organizimin politik osman në viset shqiptare (ndarja administrative, krahinat autonome); pashallëqet e mëdha: organizimi politik, ekonomik dhe kulturor të tyre; jetën e pashallëqeve (Shkodrës, Janinës);

Linja shpjegon sistemin e ri të timarit dhe pasojat e tij. Ajo përshkruan rolin e shkollave katolike në shek. XVII në përhapjen e arsimit shqip, rëndësinë e veprave të shkrimtarëve shqiptarë në shek. XVI-XVII. Linja trajton

rrethanat në të cilat u krijua çifligu dhe tiparet e tij dhe dallimet e zhvillimit ekonomik të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII, përpjekjet për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e kulturës, Onufri dhe veprën e tij. Nëpërmjet kësaj linje nxënësit mësojnë për gjendjen e kishës katolike dhe ortodokse pas pushtimit osman dhe argumentojnë përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare. Linja shpjegon përpjekjet shtet formuese, si u krijua Pashallëku i Shkodrës dhe ai i Janinës, rëndësinë e tyre, mënyrën e jetesës në këto pashallëqe.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
<p>Shqipëria gjatë sundimit osman (5 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë faktorët që ndikuan në ndryshimin e emrit nga arbër në shqiptar; • të shpjegojnë sistemin e ri të timarit dhe pasojat e tij; • të bëjnë dallimet e zhvillimit ekonomik të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII (Shkodër, Berat, Prizren, Voskopojë etj.); • të tregojnë përpjekjet e shqiptarëve për ruajtjen e gjuhës shqipe; • të evidentojnë faktorët që ndikuan në përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare; • të përshkruajnë format e organizimit politik e administrativ në Shqipëri gjatë sundimit osman; 	<p>Ndikimi i kulturës osmane dhe evropiane në Shqipëri gjatë periudhës së sundimit osman</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë zhvillimin e artit, e kulturës, e arkitekturës, e arsimit dhe e fesë gjatë kësaj periudhe; • të përshkruajnë veprën e Onufrit, David Selenicasit etj., si dëshmi e ndikimit të kulturës evropiane në Shqipëri; • të vlerësojnë përpjekjet e shqiptarëve për ruajtjen e traditave dhe të objekteve historike. <p>Ndikimi i shkollave katolike në shek. XVII në përhapjen e arsimit shqip</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë rolin e shkollave katolike dhe prelatëve katolikë në shek. XVII në përhapjen e arsimit shqip. 	<ul style="list-style-type: none"> • Spahinj • Esnafë • Ziamet • Pashallëk • Kanunname • Elajet • Vezirë • Paria • Oxhaqe

	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë termin pashallëk si formë e organizimit politik të shqiptarëve brenda Perandorisë Osmane; • të tregojnë në hartë shtrirjen e Pashallëkut të Shkodrës dhe të Janinës; • të tregojnë rrugën e formimit duke përshkruar mënyrën e jetesës në këto pashallëqe; • të vlerësojnë rëndësinë e këtyre pashallëqeve; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Sulejmani i II, Mehmet Pashë Bushatliu dhe Kara Mahmut Pasha, Ali Pashë Tepelena, Onufri, Gjon Buzuku, Frank Bardhi, Pjetër Budi; Pjetër Bogdani etj. 	<p>Feja në Shqipëri gjatë shek. XV-XIX</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojnë pluralizmin fetar në shoqërinë shqiptare; • të vlerësojnë tolerancën fetare. 	
--	--	---	--

LINJA: RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE (1830 – 1912)

Orë të sugjeruara: 6 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime: mbi periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare: fillimet, tiparet dalluese, rilindësit e parë; emancipimin politik kulturor dhe arsimor të shqiptarëve; Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, rëndësinë e saj; emancipimin kulturor dhe arsimor të shqiptarëve; rolin e vatrave patriotike të diasporës shqiptare (Turqi, Rumani, SHBA).

Linja trajton lëvizjen kombëtare shqiptare përballë ndryshimeve të reja politike në Perandorinë Osmane (kongreset kulturore arsimore, kryengritjet antiosmane të viteve 1911-1912).

Nxënësit aftësohen për Kryengritjen e Malësisë së Madhe, Memorandumin e Greçes, Kryengritjen E Përgjithshme të vitit 1912; Luftën e Parë Ballkanike dhe shpalljen e Pavarësisë (Kuvendi i Vlorës); zhvillimin e arsimit dhe të kulturës gjatë Rilindjes Kombëtare; Kongresin e Manastirit dhe të Elbasanit.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyç
<p>Shqipëria gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare (6 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë kushtet historike të lindjes së Rilindjes Kombëtare; • të identifikojnë tiparet dalluese të Rilindjes Kombëtare; • të rendisin çështjet kryesore të platformës së Lidhjes së Prizrenit; • të përshkruajnë veçoritë e kryengritjeve antiosmane gjatë viteve 1911-1912; • të argumentojnë karakterin kombëtar të Memorandumit të 	<p>Ndikimi i Rilindjes Evropiane dhe nacionalizmit ballkanik te rilindësit shqiptarë</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë ndikimin e nacionalizmit ballkanik dhe Rilindjes Evropiane te rilindësit tanë. <p>Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit për copëtimin e trojeve shqiptare</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojnë ndryshimin ndërmjet dy traktateve në raport me trojet shqiptare. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rilindje • Nacionalizëm • Ideologji • Karname (Kanuni i Lidhjes së Prizrenit) • Diasporë • Autonomi • Pavarësi

	<p>Greçes;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojnë karakterin e Luftës së parë Ballkanike dhe cili qe qëndrimi i shqiptarëve ndaj saj; • të përshkruajnë si u kalua nga platforma autonomiste në atë të Pavarësisë; • të vlerësojnë rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Jeronim de Rada, Thimi Mitko, Hasan Tahsim, Naum Veqilharxhi, Bismarku, Mehmet Ali Pasha, Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Pandeli Sotiri, Sami Frashëri, Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Ded Gjo Luli, Hasan Prishtina etj. 	<p>Platforma politike kombëtare dhe tiparet e saj 1878-1912</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë platformat politike: të Lidhjes së Prizrenit, të periudhës pas vitit 1880 gjatë kryengritjeve antiosmane; • të vlerësojnë rolin që ato patën për Shqipërinë. 	
--	--	--	--

LINJA: SFIDAT E SHTETIT TË PAVARUR SHQIPTAR 1912 – 1924**Orë të sugjeruara: 7 orë**

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime: mbi përpjekjet për krijimin e shtetit kombëtar (qeverinë e Vlorës, pleqësinë e Durrësit dhe konferencën e Ambasadorëve në Londër).

Linja përshkruan Shqipërinë në Luftën e Parë Botërore (zonat e pushtimit, Kongresin e Durrësit dhe çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes).

Nëpërmjet kësaj linje nxënësit mësojnë për zhvillimet politike të shtetit shqiptar 1920-1924 (Kongresin e Lushnjës, parlamentarizmin, krizat politike dhe arsyet, lëvizjen e qershorit dhe shkaqet e dështimit të saj).

Linja trajton ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike në shtetin shqiptar 1920-1924 (përpjekjet për arsimin kombëtar, për institucionet fetare të pavarura, për artin dhe për kulturën, për lëvizjen e gruas).

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar (2 orë)	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë në ç'`rethana u formua qeveria e Ismail Qemalit, qëndrimin që mbajti ajo ndaj vendimeve të Konferencës së Londrës dhe masat e saj në fushën arsimore dhe ekonomike; • të shpjegojnë rrethanat e ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri; • të njohin bazën ligjore të shtetit (statutin organik) shqiptar; • të përshkruajnë 	<p>Fuqitë e Mëdha për njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • të flasin për vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për kufijtë dhe njohjen e Pavarësisë; • të përshkruajnë qëndrimet që u mbajtën në Konferencën e Ambasadorëve në Londër për Shqipërinë. <p>Konferenca e Paqes së Parisit</p> <ul style="list-style-type: none"> • të bëjnë krahasimin e vendimeve të Konferencës 	<ul style="list-style-type: none"> • Pleqësi • Kadiu • Sovranitet • Konservatorë • Turkomanë • Statuti • Antanta • Status

	<p>qëndrimin që mbajti qeveria e Vidit pas caktimit të kufijve të Shqipërisë, veçanërisht me Lëvizjen Vorio-Epiriote;</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë gjendjen e brendshme kaotike të Shqipërisë gjatë kësaj periudhe. 	<p>së Ambasadorëve të Londrës 1913 me atë të Parisit 1921;</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë ruajtjen e statusit të pandryshueshëm të kufijve. <p>Shteti shqiptar 1912 – 1920</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë dokumentet që shprehin organizimin e shtetit në vitet: 1912, 1914, 1920; të krahasojnë dokumentet themelore të shtetit, duke nxjerrë të përbashkëtat dhe veçoritë e tyre. <p>Ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike në shtetin shqiptar 1920-1924 (përpyekjet për arsimin kombëtar, për institucionet fetare të pavarura, për artin dhe kulturën, për lëvizjen e gruas)</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë dhe të vlerësojnë ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike në shtetin shqiptar 1920-1924. 	
--	--	--	--

		Test <ul style="list-style-type: none"> të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve, duke treguar sfidat e shtetit të pavarur shqiptar. 	
Shqipëria në Luftën e Parë Botërore (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> të flasin për pushtimin e Shqipërisë dhe viset e tjera shqiptare gjatë Luftës I Botërore dhe të nxjerrin në pah detyrat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë kësaj lufte; të përshkruajnë qëndrimin që mbajtën italianët, austro-hungarezët dhe francezët ndaj shqiptarëve; të përshkruajnë qëndrimin e delegacioneve shqiptare në Konferencën e Paqes; të përshkruajnë qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare, duke 		

	evidentuar qëndrimin e SHBA-së.		
Zhvillimet politike të shtetit shqiptar 1920-1924 (3 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • të identifikojnë domosdoshmërinë e thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës; • të listojnë vendimet e Kongresit Kombëtar të Lushnjës; • të përshkruajnë përpjekjet e shtetit shqiptar për ruajtjen e tërësisë tokësore: Lufta e Vlorës e Koplikut e Dibrës; • të shpjegojnë shkaqet dhe dështimin e Lëvizjes së Qershorit 1924; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Dom Nikollë Kaçorri, Vehbi Agolli, Myfit Libohova; Esat Pashë Toptani, Vilhelm Vidi, Turham Përmeti, Çerçiz Topulli, Isa Boletini, Azem Galica, Aqif Biçaku, Eshref Frashëri, Ahmet Zogu, Sulejman Delvina, Fan S. Noli etj. 		

LINJA: KONSOLIDIMI I SHTETIT SHQIPTAR (1925-1939)

Orë të sugjeruara: 5 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime mbi organizimin politik të shtetit shqiptar nën drejtimin e Ahmet Zogut - nga Republika në Monarki, kompetencat e mbretit dhe të parlamentit, si dhe masat që u morën për vendosjen e shtetit ligjor. Linja shpjegon marrëdhëniet e shtetit shqiptar me jashtë (Jugosllavi, Itali). Lëvizjet politike dhe kulturore në Shqipëri; ndryshimet në jetën shoqërore dhe atë ekonomike (ligjet për Reformën Agrare, për divorcin, për heqjen e ferexheve, për arsimin, ndryshimin e fizionomisë së qyteteve).

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
<p>Jeta politike, ekonomike dhe shoqërore e shtetit shqiptar (1925-1939) (5 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë masat e Ahmet Zogut për stabilizimin e situatës në Shqipëri; • të përshkruajnë organizimin e shtetit të Ahmet Zogut; • të tregojnë rrugën e kalimit nga republika në monarki; • të dallojnë grupet politike-shoqërore që vepronin në Shqipëri dhe jashtë saj; • të dallojnë format e përdorura nga opozita dhe nga qeveria për të 	<p>Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Jugosllavinë dhe me Italinë</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë politikën e fqinjësisë së mirë të shtetit shqiptar; • të vlerësojnë orientimin e marrëdhënieve shumëpalëshe të shtetit shqiptar ndaj shtetit italian. <p>Ndikimi i vendeve evropiane në jetën qytetare në Shqipëri</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë ndryshimet që pësoi jeta në Shqipëri nën ndikimin e Evropës: në 	<ul style="list-style-type: none"> • Republikë presidenciale • Senat • Xhelepi • Opozitë • Elegji • Oksidentalizëm • Evropianizim

	<p>realizuar objektivat politikë të tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë veçoritë e arsimit dhe të kulturës gjatë monarkisë; të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Tefta Tashko Koço, Migjeni, Ernest Koliqi, Gjergj Fishta, Kol Idromeno, Ndoc Martini etj. 	<p>legjislacion, në mënyrën e jetesës, në urbanizim etj.</p> <p>Shqipëria drejt evropianizimit</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë masat që morri shteti shqiptar në fushën e arsimit, të kulturës, të artit e të arkitekturës, të ekonomisë dhe të emancipimit të përgjithshëm të shoqërisë shqiptare. 	
--	--	--	--

LINJA: SHQIPTARËT DHE LUFTA E DYTË BOTËRORE 1939 – 1944

Orë të sugjeruara: 4 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime mbi periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Kjo linjë përshkruan dhe shpjegon për Shqipërinë nën pushtimin italian; forcat e rezistencës antiitaliane: ngjashmërinë dhe diferencat; përpjekjen për krijimin e një fronti antifashist gjatë luftës; Shqipërinë nën pushtimin gjerman dhe përfundimin e luftës; misionet e aleatëve në Shqipëri dhe kontributin e tyre gjatë Luftës II Botërore.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
Lufta e Dytë Botërore 1939 – 1944 (4 orë)	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> të rendisin masat që mori 	Ndikimi i Rusisë në vendet e Evropës Lindore në fitoren kundër fashizmit	<ul style="list-style-type: none"> Dekalogu Mëkëmbë Kuisling Divizion

	<p>Italia për pushtimin e Shqipërisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë qëndresën e shqiptarëve; • të identifikojnë programet politike që u formuan gjatë Luftës së Dytë Botërore; • të vlerësojnë qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Shefqet Vërlaci, Mustafa Kruja, Abaz Kupi, Mujo Ulqinaku, Françesko Jakomoni, Konti Çiano, Benito Musolini, Mit'hat Frashëri, Enver Hoxha, Qemal Stafa, Myslym Peza, Safet Butka etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë faktorët që penguan hapjen e Frontit Lindor me fillimin e Luftës së Dytë Botërore; • të vlerësojnë rolin që luajti Fronti i Lindjes krahas fronteve të tjera në disfatën e forcave nazifashiste. <p>Përpyjekja për krijimin e një fronti antifashist gjatë luftës</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojnë Konferencën e Pezës dhe të Mukjes si përpjekje për krijimin e frontit antifashist; • të përcaktojnë shkaqet e dështimit të Konferencës së Mukjes; • të shpjegojnë tiparet e reja që mori lufta pas Konferencës së Mukjes. <p>Lufta kundër pushtuesit italian dhe gjerman dhe fazat e zhvillimit të saj</p>	
--	---	---	--

		<ul style="list-style-type: none"> • të dallojnë tri fazat që kaloi Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri: rezistencën 1939-1942, luftën e armatosur 1942-1943, tiparet e reja që mori lufta gjatë viteve 1943-1944. <p>Misionet e aleatëve në Shqipëri dhe kontributi i tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë rrugën kronologjike të vendosjes së misioneve të aleatëve gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri; • të vlerësojnë qëllimin e misioneve të vendosura pranë qendrave të nacionalistëve dhe të komunistëve; • të evidentojnë veprat kryesore (kujtimet) të këtyre misionarëve, të shkruara pas luftës. 	
--	--	--	--

LINJA: SHQIPËRIA GJATË REGJIMIT KOMUNIST 1945 – 1990

Orë të sugjeruara: 8 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime: mbi vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri 1944 – 1948; masat politike dhe ekonomike që shoqëruan vendosjen e regjimit antidemokratik dhe atij komunist në Shqipëri; zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, falsitetin demokratik të tyre; Asambleenë Kushtetuese, opozitën kundër regjimit antidemokratik dhe komunist; tiparet e jetës politike dhe ekonomike gjatë regjimit komunist 1948 – 1978; kolektivizimin dhe industrializimin e vendit; ndryshimet në jetën shoqërore dhe kulturore gjatë viteve 1948 – 1978; luftën e klasave dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, si tipar i vazhdueshëm i regjimit komunist; qëndresën e forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit.

Linja trajton, gjithashtu, marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë 1945 – 1990; Konferencën e Paqes dhe qeverinë shqiptare; marrëdhëniet Shqipëri – Jugosllavi gjatë viteve 1944 – 1948; marrëdhëniet Shqipëri – BRSS gjatë viteve 1948 – 1960; marrëdhëniet Shqipëri – Kinë gjatë viteve 1960 – 1978; orientimin lindor dhe faktorët që përcaktuan këtë orientim; marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët dhe Bllokun Perëndimor (1944 – 1990).

Linja përshkruan dukuritë më tipike të politizimit dhe të idealizimit të skajshëm të jetës së vendit; forcimin e represionit të regjimit komunist; tiparet e shtetit diktatorial komunist; vetizolimin e shtetit komunist (1978 – 1990).

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari Të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
<p>Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri 1944-1948 (2 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të listojnë masat që u morën për vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri; • të përshkruajnë masat politike dhe ekonomike që ndërmori regjimi komunist në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948; • të evidentojnë pasojat e këtyre masave; • të përshkruajnë qëndresën e forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj këtij 	<p>Marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët dhe Bllokun Perëndimor (1944-1990)</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë marrëdhëniet e qeverisë shqiptare me SHBA-në, me Anglinë dhe me demokracitë e tjera perëndimore, duke shpjeguar shkaqet e ftohjes së këtyre marrëdhënieve; • të shpjegojnë marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinje (Greqi dhe Itali). 	<ul style="list-style-type: none"> • Diktaturë e proletariatit • Konventë ekonomike • Grupi i deputeteve • Opozitë • Kryengritje antikomuniste • Parti-shtet • Byro politike • Kulakë • Ekonomi e centralizuar • Luftë klasash • Sigurimi i Shtetit

	<p>regjimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë përdorimin e dhunës që ushtroi regjimi komunist ndaj opozitës. 	<p>Diktatorët komunistë dhe persekucioni</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë figurat kryesore të regjimit komunist dhe format e persekutimit që ata morën ndaj figurave demokratike të shoqërisë shqiptare; • të evidentojnë disa nga figurat demokratike të persekutimit komunist, duke evidentuar kontributin që ata dhanë për Shqipërinë. <p>Fotomontazh mbi përdorimin e dhunës gjatë regjimit komunist</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vendosin fotografi që shprehin këto dukuri: aspekte nga pushkatimi; pamje nga burgjet e Spaçit, Burrelit, Qafë Barit etj; • të pasqyrojnë punët e rënda të të burgosurve; • të ilustrojnë jetën e të internuarve dhe kampet e internimit. <p>“Krijimi i njeriut të ri, vepër e partisë”</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë format e përdorura për ideologjizimin e çdo qytetari; • të përcaktojnë pozitën reale të 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjykatë Popullore • Republikë popullore • Asamble Kushtetuese • Kolektivizim • NATO • KNER • Kamp socialist • Revizionizëm • Imperializëm
--	--	---	---

		qytetarit në raport me të drejtat themelore demokratike, si: liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e besimit fetar etj.	
<p>Regjimi komunist në Shqipëri 1948-1978 (tipare të jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore gjatë viteve 1948 – 1978) (2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë diktaturën e proletariatit si forma kryesore e regjimit komunist; • të vlerësojnë Kushtetutën e vitit 1976 si baza ligjore antidemokratike e këtij regjimi; • të shpjegojnë rrugën e kalimit nga reforma agrare në kolektivizimin e përgjithshëm të bujqësisë; • të analizojnë pasojat që pati ky proces për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare; • të shpjegojnë masat që ndërmori regjimi komunist për zhdukjen e pronës private dhe industrializimin socialist të vendit; • të analizojnë pasojat që patën këto masa për shoqërinë shqiptare; • të përshkruajnë ndryshimet që pësoi shoqëria shqiptare gjatë viteve 1948-1978 në 		

	<p>fushën e arsimit, artit, kulturës, fesë, shëndetësisë, roli i gruas në këtë shoqëri;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut si tipar i vazhdueshëm i regjimit komunist. 		
<p>Marrëdhëniet ndërkombëtare e të Shqipërisë 1945-1990 (2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë pozitën e qeverisë shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris; • të shpjegojnë orientimin lindor dhe faktorët që përcaktuan këtë orientim; • të përshkruajnë veçoritë e marrëdhënieve ndërshtetërore Shqipëri – Jugosllavi, duke evidentuar faktorët që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat; • të shpjegojnë shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë; • të shpjegojnë zbatimin e sistemit stalinist për ngritjen e industrisë dhe 		

	<p>kolektivizimin e fshatit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojnë faktorët që çuan në prishjen e marrëdhënieve me BRSS-në dhe pasojat; • të shpjegojnë shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare pas prishjes së marrëdhënieve me BRSS-në; • të shpjegojnë tiparet e marrëdhënieve të qeverisë shqiptare me Kinën dhe ndikimin e tyre në shoqërinë shqiptare; • të shpjegojnë shkaqet që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve. 		
<p>Vetizolimi i shtetit komunist gjatë viteve 1978-1990 (2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojnë veçoritë e politikës së qeverisë komuniste shqiptare, të cilat çuan në izolimin e plotë të vendit; • të evidentojnë situatën e vështirë ekonomike dhe politike të shoqërisë shqiptare; • të përshkruajnë aspekte të shfaqjes së pakënaqësisë masive dhe individuale ndaj 		

regjimit komunist;		
<ul style="list-style-type: none"> të analizojnë prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat. 		

LINJA: RËNIA E REGJIMIT KOMUNIST. FITORJA E DEMOKRACISË

Orë të sugjeruara: 6 orë

Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime: mbi periudhën e rënies së rrëgjimit komunist në Shqipëri dhe fitores së demokracisë. Kjo linjë përshkruan dhe shpjegon krizën e regjimit komunist. Ajo trajton Shqipërinë nga viti 1992 deri në ditët e sotme; analizon disa nga tiparet e krizës ekonomike, kryesisht në bujqësi dhe në industri, zhvillimin e pandërprerë të luftës së klasave dhe përdorimit të dhunës. Linja përshkruan disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste.

Nëpërmjet kësaj linje, nxënësit mësojnë për lëvizjen demokratike, pluralizmin politik dhe krijimin e partive politike, shpërthimin e lëvizjes demokratike në të gjithë vendin, që çoi në zgjedhjet e 22 Marsit 1992 dhe fitoren e forcave demokratike.

Linja, gjithashtu, përshkruan Shqipërinë nga tranzicioni në integrimin euroatlantik 1990 deri në ditët e sotme; ndryshimet politike, ekonomike dhe shoqërore në vitet e tranzicionit; përpjekjet e shtetit shqiptar për integrim në strukturat euroatlantike; sfidat e shoqërisë shqiptare sot.

Nënlinja	Objektivat	Veprimtari të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
Kriza e regjimit komunist (2 orë)	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> të identifikojnë disa nga tiparet e krizës ekonomike, kryesisht në bujqësi dhe në industri; të përshkruajnë disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste; të shpjegojnë rrethanat e 	<p>Përpjekjet e shtetit shqiptar për integrim në strukturat euroatlantike</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë rolin që pati për Shqipërinë anëtarësimi i saj në NATO; të shpjegojnë kontributin që jep sot shteti shqiptar në kuadrin e Aleancës së Atlantikut; të vlerësojnë rolin e shtetit shqiptar në forcimin e marrëdhënieve ndërshtetërore në rajonin e Ballkanit; 	<ul style="list-style-type: none"> Demokraci Pluralizëm Parti Politike Fushatë elektorale E drejta e votës Votim i fshehtë Tranzicion Integrimi euroatlantik NATO Rajon ballkanik BE

	krijimit të partisë politike.	<ul style="list-style-type: none"> të evidentojnë hapat e ndërmarrë nga qeveria shqiptare drejt integritit të plotë të saj në BE. <p>Test</p> <ul style="list-style-type: none"> të provojnë dhe të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve për linjat shtatë, tetë, nëntë dhe dhjetë. 	<ul style="list-style-type: none"> Zgjedhje të lira Liri e shtypit Ekonomi e lirë e tregut Shteti i së drejtës Barazi para ligjit
Lëvizja demokratike, pluralizmi politik dhe krijimi i partive politike (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë partinë demokratike si qendra më e rëndësishme e forcave opozitare, duke evidentuar vlerat demokratike të programit të saj; të përshkruajnë shpërthimin e lëvizjes demokratike në të gjithë vendin që çoi në zgjedhjet e 22 Marsit 1992 dhe në fitoren e forcave demokratike. 		
Shqipëria nga tranzicioni në integrimin euroatlantik 1990 – sot (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë veçoritë e sistemit të ri politik ekonomik e shoqëror të krijuara pas këtyre zgjedhjeve; të përshkruajnë rotacionin 		

	<p>politik si element i sistemit të ri demokratik;</p> <ul style="list-style-type: none"> të vlerësojnë procesin e zgjedhjeve elektorale si themel të demokracisë; të vlerësojnë rolin e shtetit shqiptar në sfidën e integritetit. 		
<p>LINJA: SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE POLITIKË (1912-SOT)</p> <p>Orë të sugjeruara: 8 orë</p>			
<p>Përmes kësaj linje, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi, qëndrime për shqiptarët jashtë kufijve politikë të Shqipërisë 1912 – 1944; shqiptarët në Serbi e në Jugosllavi; shqiptarët në Greqi (Çamëria); shqiptarët jashtë kufijve politikë 1945 deri në ditët e sotme; gjendjen ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Jugosllavi 1945 – 1968.</p> <p>Linja trajton periudhën nga liberalizimi në mohimin e të drejtave nga shpërbërja e Jugosllavisë në Pavarësinë e Kosovës. Përshkruan, gjithashtu, kontributin e shoqërisë shqiptare sot, për ndërkombëtarizimin e problemit çam; zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës sot.</p>			
Nënlinja	Objektivat	Veprimtari Të sugjeruara	Koncepte dhe terma kyçe
<p>Shqiptarët jashtë kufijve politikë të Shqipërisë. 1912 – 1944. Shqiptarët në jugosllavi dhe Greqi (Çamëria) (3 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> të tregojnë format e dhunës e të terrorit serbo-malazez e grek që shkaktuan rezistencën shqiptare pas vitit 1913; të shpjegojnë luftën antifashiste në Çamëri dhe përpjekjen e grekëve për të minimizuar këtë luftë; 	<p>Kontributi i shoqërisë shqiptare sot për ndërkombëtarizimin e problemit çam</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë rolin e shoqërisë shqiptare, të shtypit, të medias në mbrojtjen e të drejtës çame. <p>Pavarësia e Kosovës</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajnë zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës sot; 	<ul style="list-style-type: none"> Shkombëtarizim Amendament Problemi çam

	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë qëllimin e reformës agrare për kolonizimin e Kosovës dhe shpronësimin e shqiptarëve; • të përcaktojnë synimet e platformës së shpërnguljes së shqiptarëve dhe drejtimin e shpërnguljes së tyre; • të rendisin vendimet e Konferencës së Bujanit dhe të përshkruajnë luftën antifashiste në Kosovë duke nxjerrë në pah ndërhyrjen e udhëheqjes jugosllave dhe qëndrimin e forcave nacionaliste. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë sfidat që përballet shoqëria kosovare. 	
Shqiptarët jashtë kufijve politikë 1945 – sot (3 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi 1945-1968; • të shpjegojnë rëndësinë e Kushtetutës së vitit 1974 për Kosovën; • të përshkruajnë politikën e rivendosjes së autoritetit serb në Kosovë, duke evidentuar dhunën që ai ushtroi ndaj shtetasve 		

	<p>kosovarë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojnë procesin e luftës së Kosovës për pavarësi, duke evidentuar rolin që patën ndërkombëtarët në këtë proces; • të rendisin faktorët që çuan në pavarësinë e Kosovës; • të vlerësojnë rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën; • të njohin disa nga figurat historike që i përkasin kësaj linje, si: Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka, Josif. B. Tito, Ibrahim Rrugova, Adem Demaçi, Adem Jashari; Hashim Thaçi, Presidenti Klinton, Toni Bler, Bernard Kushner, Agim Çeku, Ramush Haradinaj. 		
--	---	--	--

ⁱ Orët e sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen *të sugjeruara*, sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit/es), që të shtojë ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10%, sipas nevojave të klasës.

ⁱⁱ Veprimtari të sugjeruara janë orë praktike në funksion të përpunimit dhe thellimit të njohurive të reja, si dhe të aftësimin praktik të nxënësve. Këto veprimtari praktike janë dhënë për çdo nënlinjë, duke u ndarë në raportin 30% ose 40% veprimtari, kundrejt 70% ose 60% njohuri të reja. Janë të sugjeruara, sepse përdoruesit e programit (hartuesit e tekstit dhe mësuesit) mund t'i ndryshojnë këto veprimtari të sugjeruara, në funksion të nevojave të

përpunimit të lëndës dhe të përshtatjes së këtyre veprimtarive me ngjarjet e reja në kohë. Në rubrikën *veprimtari të sugjeruara* mund të jenë dhënë më shumë se 40% tema veprimtarish praktike, që i përkasin një linje për përpunimin e njohurive. Përdoruesit e programit duhet të përzgjedhin në masën 40 %, ato veprimtari që i mendojnë më të përshtatshme, për përpunimin e objektivave të linjës dhe të nënlinjës.